

Prof. Eqrem Çabej

## PROBLEMI I VENDIT TË FORMIMIT TË GJUHËS SHQIPE

### I

Në paleoetnologjinë e Gadishullit Ballkanik dhe në historinë e lashtë të gjuhëve të tij, një nga problemet kryesore, sikundër dihet, e përbën çështja e burimit të shqipes, pra çështja e lidhjes së afërsisë me gjuhët jogreke të kohës së vjetër, dhe ajo e vendit ku kjo gjuhë u formua si një madhësi e caktuar e më vete. Këto çështje kuptohet se janë të lidhura në mes të tyre, ato bile përbëjnë një tërësi të plotë e të pandarë: treva ku është përfutuar një idiomë si një individualitet gjuhësor i përcaktuar qartë në vetvete, paravendon një lidhje të ngushtë me gjuhën ose gjuhët që në kohët e para kanë qenë folur në atë trevë ose në viset afër me të.

Ky kompleks çështjesh nuk përbën vetëm një problem gjuhësor, po njëkohësisht dhe një problem etnografik e arkeologjik, e kryesisht një problem historik, dhe përtej këtyre, një problem të metodës. Gjuhët nuk janë madhësi që ekzistojnë në vetvete; ato janë të lidhura me njerëzit që i flasin, me popujt si bartësit e atyre gjuhëve, prandaj historia e gjuhëve në thelb është pasqyrë e historisë së popujve e të kulturave. Në këtë vështrim, në një trajtim të çështjes së burimit të shqipes dhe të territorit të formimit të saj si gjuhë, trajtim që të synojë në diçka tërësore, krahas me përfundimet gjuhësisë duhej të viheshin në peshë dhe ato të disiplinave të afra. Ndërkaq ky parim, i drejtë metodologjikisht brenda një referati si ky, është vështirë të ndiqet. Pa lënë pas dore situatën e përgjithshme gjeografike-historike, këtu mendojmë ta kufizojmë detyrën tonë nga ana metodike, dhe duke lënë mënjanë rezultatet e disiplinave të tjera, t'i sillemi problemit vetëm me mjete linguistike, aq më shumë kur dihet se jo gjithmonë njësitë kulturele dhe njësitë gjuhësore janë baras e puthiten në mes të tyre. Për një trevë si Gadishulli Ballkanik, ku për kalimin nga situata etnike e lashtë në të sotmen nuk ka lajme e të dhëna konkrete, ku lëvizjet e popujve e të fiseve kanë qenë aq të shpeshta, vështirësohet çështja e burimit etnik të njësisë të sotme nacionale. Do të ishte punë jo shkencore, bile edhe naive, të projektoheshin rrethanat e sotme si të thuash me vijë të drejtë në të kaluarën. Gjuhësia, përkundrazi, ka diçka rezultative në vetvete; ajo paraqet refleksin e fundit dhe të sigurtë të proceseve të ndryshme historike dhe etnike

të kohëve të para, procese përndryshe të pakapshme mirë. Në këto rrethana edhe për rasën tonë është e mundshme, bile edhe e rekomandueshme, që me një interpretim sa më preciz të fakteve gjuhësore që janë në dispozicion, të tentohet mbi një bazë gjuhësore një zgjidhje e problemit që këtu shtrohet.

Kriteri që lënda përcakton gjer në një farë shkalle edhe metodën, vlen edhe për problemin tonë. Vobeksia e materialit kërkon këtu dhe një metodë më vete të kërkimit. Në situatën e veçantë ku tradita e shkrimit të shqipes, me gjendjen e sotme të njohurive tona, fillon vetëm me shekullin e 15., e çështja e gjeenezës dhe e territorit të formimit të saj përkundrazi i përket një periode shumë përpara historisë së bartësve të saj, kjo metodë nuk ka veçse të mbështetet kryesisht në rindërtim (rekonstrukcion) e në krahasim. Aty është puna të kërkohen fijet që lidhin të kaluarën me të tashmen dhe duke u nisur prej gjendjes së sotme, të ngjitemi në shkallët e përparme. Aty ku këto fije paraqiten të këputura, mund të përpiqemi që nëpërmjet të krahasimit gjuhësor t'i lidhim përsëri pas mundësive, dhe të plotësojmë ç'mund të plotësohet.

Pas këtyre shtjellimeve të një karakteri të përgjithshëm le t'i sillemi tani temës sonë, kërkimit të vendit të formimit të gjuhës shqipe. Historia e një gjuhe — ashtu si dhe historia e popullit që e ka folë ose që e flet — është një varg i pakëputur, një kontinuitet; veçse dihet që në bazë të një parimi të përgjithshëm të nëndarjes e të klasifikimit, për arësye metodologjike po edhe praktike, ajo zakonisht zbërthehet në një periode prehistorike dhe në një periode historike, dhe këto vetë në nënperioda të veçanta. Duke u nisur në këtë mes nga mendimi që midis lidhjeve farefisnore të një gjuhe dhe vendosjes gjeografike të saj ekziston një farë raporti, me të dhënat që me anë të krahasimit linguistik janë nxjerrë gjer më sot për vendin që zë shqipja në rrethin e gjuhëve të afra me të, mund të shkohet një hap përpara edhe në çështjen e përcaktimit territorial të periodës parabalkanike të prehistorisë së saj. Fromulimi i Franz Boppit që gjuha shqipe „në elementet e saj themelore me asnjërin nga gjuhët motra (Boppi „motrat sanskrite“) të kontinentit tonë nuk ka ndonjë lidhje më të ngushtë, ose, aq më pak, ndonjë lidhje rrjedhjeje, burimi”, ruan vlerën e tij edhe sot, vetëm se përparimet që janë arritur në gjuhësinë krahasimtare indoeuropiane në këtë një shekull që ka kaluar nga ajo kohë, lejojnë të ravizohet disi më saktë ky vend afërish gjuhësore. Në zhvillimin fonetik — për të prekur vetëm tiparet kryesore — shqipja me reflektimin e aspiratës *bh*, që paravendoset për indoeuropianishten, me anë të okluzivit të thjeshtë *b*, shkon me shumicën e gjuhëve indoeuropiane; me kalimin e palataleve indoeuropiane lindore, indoiranishten, armenishten, sllavishten, baltishten; me puqjen e bashkimit e *o*-së dhe *a*-së së shkurtër në *a* në Europë, shkon me gjuhët gjermanike dhe me baltishten (e sllavishten). Nga fusha e strukturës morfologjike, sidomos nga ajo e fleksionit, prej sistemit nominal thuajse asgjë me peshë anësore nuk mund të nxirret në këtë mes, ngaqë shqipja aty, me bjerrjet që ka pësuar në lëm të lakimit, si tek emri si tek përmri (pronori), ka rrahur në shumë anë shtigjet e veta.<sup>1</sup> Në fleksionin foljor, me gjithë humbjet e gjashme që ka pasur sidomos në sistem të kohëve e të mënyrave, dhe me gjithë risimet (inovacionet) që ka kryer në rrjedhë të zhvillimit gjuhësor, risime

<sup>1</sup> Khs. edhe H. Pedersen, *Realexikon der Vorgeschichte I* (1924) 223.

që kanë lidhje me ato humbje, prapëseprapë mund të qiten disa tipare afërie. Kështu preteriti i tipit *mblodha* ndaj *mbledh*, si e vuri re sëpari Gustav Meyeri, përgjigjet *lëgi, sēdi, got. rētum, qēmun* dhe lit. *sēdes bēges*.<sup>2</sup> Më anë tjetër ndërndërrimi (alternimi) i sufiksit të prezentit *-io/ -i* që ka latinishtja (*cipio, -is, -it*) e gotishtja, sikundër e vërejtë A. Meillet,<sup>3</sup> paraqitet dhe në fleksionin e foljeve më *-i-* të shqipes (*vras, vret, vret*). Pak ka tërhequr vëmendjen gjer tani fakti i vënë re së pari nga dijetari arbëresh Dhimitër Kamarda,<sup>4</sup> që mbaresat primare të mesores që ka greqishtja, dalin së paku pjesërisht edhe në shqipen, në mënyrë që *pheromai*, të cilën gjer më sot e kanë krahasuar me prus. e vj. *asmai* „jam”, piqet me trajtën *vishem* të shqipes, ku duan shtuar dhe *phéretai: vishetë, pherometha: vishemi, phérontai: vishenë*. Më në fund, nëse barazimi arm. *utem* „unë ha”; *eker* „ai hëngri”; shq. *ha, hëngri*, që vendoi H. Pedersen,<sup>5</sup> mbetet i drejtë, atëherë shqipja ka pasur edhe augmentin, ashtu si indoiranishtja, armenishtja, frigishtja e greqishtja. Konkordancat pjesore (parciale) të elementeve të leksikut të trashëguar të shqipes, të cilat shpeshherë mbështeten në interpretime tashmë të kapërcyera, si të tilla për një pjesë të mirë kanë nevojë të rishqyrtohen, prandaj ende nuk mund të përdoren me dobi, mendojmë, për një gjykim etimologjik përfundimtar në formë statistikore. Megjithatë, në gjendjen e sotme të studimeve,<sup>6</sup> qoftë edhe në formë provizore mund të thuhet që shqipja paraqet lidhje leksikore me shumicën e gjuhëve indoevropiane, ndër to në mënyrë të veçantë të gjuhët evropiane veriore, e aty sidomos me gjuhët baltike, që përkimet në vetvete jo të shumta me armenishten janë më të paka se barazimet tripalëshe shqiptare-greke-armene, dhe që lidhje specifike me gjuhët anatolike gjer tani nuk kanë mundur të vërtetohen. Duke shikuar në tërësi këtë situatë prehistorike, me të cilën nuk bien në kundërshtim disa të tjera tipare që nuk u prekën këtu, shqipes si gjuhësisht si gjeografikisht do t'i njihet një farë pozicioni qëndror, ndërmjetës midis Perëndimit e Lindjes, një rezultat ky, i cili pjesërisht piqet me atë të disa dijetarëve të tjerë.<sup>7</sup> (Një qëndrim të gjashëm po shënojmë këtu rrëshqimthi — mban shqipja edhe në mënyrën e trajtimit të elementit latin).<sup>8</sup> Kur të merren parasysh më tej dhe huazimet e lashta prej iranishtes, si edhe takimet e moçme me disa nga gjuhët indoevropiane,<sup>9</sup> dhe të peshohet më anën tjetër që dy vargmale të Evropës qendrore-lindore, Karpatet dhe Beskidet, gjejnë shpjegimin e tyre me anë të shqipes, dhe vetëm me të ndër gjithë gjuhët e gjalla indoevropiane (*karpë, bjeshkë*, kjo me diftongim të mëpastajmë), atëhere nuk do të shkelet, mendojmë

<sup>2</sup> IF 5 (18) 180 vv.

<sup>3</sup> Mém. Soc. Ling. XIX (1914) 119 vv.

<sup>4</sup> Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese (1864) 287 vv.

<sup>5</sup> KZ 36 (1900) 341.

<sup>6</sup> Khs. sidomos G. Meyer Bezenbergers, *Beitrage VIII* (1883) 185 vv., *Fjalori etimologjik (191) passim*; H. Pedersen KZ 36, 341, *Reallexikon der Vorgeschichte I*, 222; N. Jokl *po aty* 92 f., IF 43 (1926) 56 v., *Wiener Zeitschrift für die Kunde des Morgenlandes XXXIV* (1927) 130 vv., *Wörter und Sachen XII* (1929) 63 vv., *Die Sprache IX* (1963) 113 cc.; W. Porzig, *Die Gliederung des idg. Sprachgebiets* (1954) VI 10; V. Pisanì, *Saggi di linguistica storica* (1959, përkatësisht 1955) 115 vv.; autori *Buletin i USHT, Seria shk. shoq. dhe Studime filologjike 1960–1968*, *Studi linguistici in onore di V. Pisanì I* (1969) 167 vv.; A. Desnickaja, *Voprosy jazykozaanya* 6 (1965) 24 vv.; E. Hamp, *The Position of Albanian* 97 vv.

<sup>7</sup> Khs. sidomos M. Budimir, *Glasnik Istor. Društva u Novom Sadu* 2 (1929) lvv. — *IF XV VII* 120.

<sup>8</sup> Autori, *Revue (roumaine) de linguistique VII* (1962) 167.

<sup>9</sup> N. Jokl, *Wiener Zeitschrift für die Kunde des Morgenlandes*, XXXIV 130 vv., *Wörter und Sachen XII* 63 vv.

në dërrasë të kalbët po të thuhet që djepi i shkallës parabalkanike të shqipes në periodën europiane të gjuhëvet indoeuropiane ka qenë në një zonë diku në veri të Gadishullit Ballkanik.

Duke kaluar tani në periodën ballkanike, aty del çështja se në cilën trevë të Gadishullit u formua kjo gjuhë, në të sotmen apo në një tjetër, dhe në këtë rasë, në cilën, një çështje që më në fund mbaron në pyetjen se prej nga kanë ardhur bartësit e saj në trevën gjuhësore të sotmen. Duke u shprehur ndryshe, shtrohet pyetja se që prej cilës periodë të historisë flitet kjo gjuhë në truallin e sotëm të saj.

Sido që të jetë përgjegjja e kësaj çështjeje, aty, sipas mendimit tonë, ka disa pika që duan pasur parasysh.

Pikësëpari dihet që formim do të thotë zhvillim. Si çdo tjetër gjuhë, edhe shqipja nuk ka dalë nga shkalla e përparme e saj si një madhësi e kryer e statike. Ajo do të kuptohet më fort si diçka që mori formë gjatë kohëve dhe tiparet e strukturës së saj, që e kanë bërë atë që është sot, sigurisht nuk u përfatuan të gjitha njëkohësisht, po në kohë të ndryshme.

Duke qenë pra çështja e vendit të formimit jo vetëm një çështje gjeografike, po edhe e historisë së gjuhës, do sjellë ndërmend, së dyti, që — sikundër u tha dhe më lart — kjo çështje trajtohet këtu nga pikëpamja thjesht gjuhësore. Ndonëse problemi i formimit të një gjuhe lidhet me atë të formimit etnik, këtu problemet gjuhësore parimisht do të shqyrtohen veçmas nga problemet etnologjike. Ne e kemi të qartë që edhe te kjo gjuhë rruga e formimit nuk ka qenë vijëdrejtë. Komponente të ndryshme, të pahetueshme më tutje, si p.sh. shpërngulje e përzierje etnike, shtegtime të brendshme, konvergjenca e elementeve të ndryshme, zhvillim nga ndryshimi në një njësi pranë zbërthimit të një-sive të dikurshme, këto kanë pjesë në përfitim të saj: proqese historike, të cilat, si u tha, duhet të mbeten jashtë shqyrtimit tonë.

Përbrenda kësaj fushe që kufizohet kështu tematikisht, nga pikëpamja gjuhësore, së treti, një gjë është e sigurtë, që, si çdo gjuhë tjetër, edhe shqipja prej shkallës së saj të lashtë, pavarësisht nga se me cilën nga gjuhët jogreke të Gadishullit Ballkanik të kohës antike është identike ajo shkallë e lashtë. Kështu në trajtimin e çështjes sonë dorajdorën mund të mbetet jashtë çështja e afërsisë gjenealogjike të shqipes, e filiacionit (birërisë) sadoqë — sikundër u tha më lart — të dy çështjet janë lidhur ngushtë ndërmjet tyre, në mënyrë që një vatrë e shqipes në Ballkanin përdimor ka lidhje kryesisht me dialektet e ilirishtes, një vatrë në Ballkanin lindor kryesisht me ato të trakishtes. Këtu mbase nuk është e tepër të kujtojmë që këto gjuhë, me përfshirje edhe të maqedonishtes bashkë me të tjera idioma të pellgut të Egjeut, me historinë e tyre të gjatë, nga pikëpamja e indoeuropeanishtes paraqesin jo një fillim, po disa faza të caktuara të zhvillimit, kalime prej neolitit të vonë në epokën e bronzit e në atë të hekurit, para se të dalin si madhësi të formuara në dritë të historisë për t'u zhdukur pastaj si gjuhë gjatë kohës antike ose nga mbarimi i saj; Nga pikëpamja e njohjes së materialit, sidomos të sistemit gramatikor, do të pranohet që për ne këto gjuhë, me përjashtim të disa mjeteve (mbeturinave) të imta, paraqesin madhësi krejt të panjohura; shpeshherë dhe arbitrar i emrave vetiakë, pak duket të jetë i tillë që të mund të pasuronte në mënyrë qenësore

njojnë konkrete të këtyre gjuhëve.<sup>10</sup> Përsa i përket lidhjes fafesisnore me shqipen si një relik i fundit që ka mbetur nga kjo tërësi gjuhësore, është për të vërejtur që gjatë diktimit të tipareve të gjashme nuk janë çmuar sa duhet dallimet jo të paka që ekzistojnë. Në pikëpamje metodike, përpara përgjasimeve që dalin, duhej bërë dallim midis barazisë së strukturave dhe një zhvillimi paralel, midis përkimeve të vërteta dhe takimeve të rastit, dhe nuk duheshin sjellë këto të fundit si dëshmi, nëpërmjet të një argumentimi kumulativ. Që në krahasimin e një gjuhe të gjallë me një të vdekur nuk duheshin lënë pas dore edhe parimi i kronologjisë si dhe ai i përkimit specifik e jo të shfaqur edhe në gjuhë të tjera, në këto pika nuk është nevoja të hyhet këtu, meqë këto kritere janë shtjelluar gjatë.<sup>11</sup>

Si i vihen kështu detyrës sonë tematikisht nga shumë anë caqe kufizimi, dhe në punë të kohës rrethi i përkimit do të përmbledhet më ngushtë. Prehistoria e shqipes mundet të ketë vazhduar në Gadishull të Ballkanit, veçse ajo gjuhësisht nuk mund të ndiqet, prandaj në këtë mes kjo çështje mund të mbetet jashtë. Çështja e vendit të formimit të gjuhës mund të shtrohet vetëm për një periudë historike, prej së cilës ka dëshmi të shkrimit, konkretisht emra vetiakë visesh e të tjera, të cilat nga një anë dalin nëpër kumte të dy gjuhëve klasike, nga ana tjetër na shfaqen sot në gojën popullore të shqipes. Dëshmia përkundrazi e mbishkrimeve, gurëve miliarë dhe e monedave qytetare të kohës antike të Gadishullit, të shkruara ose të përshkruara greqisht a latinisht, në lidhje me problemin tonë jo vetëm nuk çon peshë, po shpie bile në një rezultat negativ: Pavarësisht nga çështja nëse në ndarjen gjuhësore dysh të kësaj treve në një zonë të romanizuar dhe një të helenizuar, të vendosur për atë epokë nëpërmjet të këtyre dëshmimeve, vija e demarkacionit që pjesën perëndimore mendohet të ketë kaluar mospërmasë Shqipërisë së sotme, të ketë qenë shtrirë, sipas K. Jireçekut, më në veri, ose sipas disa dijetarëve të tjerë, si M. v. Shufflay, P. Skoku e C. Patshi, më në jug,<sup>12</sup> kjo ndarje dysh, bash mbi dëshminë e ekzistencës së një gjuhe të gjallë dhe sot e kësaj dite, nuk mund të pretendojë të ketë vlerë absolute. Sikundër vërtetojnë, mutatis mutandis, mbishkrimet turke-arabe të qyteteve më vonë të islamizuara të Gadishullit, me popullsinë e tyre që më të shumtën as nuk i di këto gjuhë lindore, ashtu edhe ndarja gjuhësisht dysh e asaj epoke të lashtë do të ketë vyer më fort për banorët e qyteteve të rysur pak a shumë në shkrim e në këndim, sesa për masat fshatare analfabete të bujqëve e të barinjve. Kjo situatë, të cilën për Maqedoninë Mommseni është i pari që e vërejt, mbi dëshminë e shqipes do të pranohet dhe për të tjera vise malatake të Europës

<sup>10</sup> "... sa punë e pasigurtë dhe e kotë është që nga fusha e një gjuhe që pak njihet, të shpjegosh etimologjikisht me çdo kusht një emër vendi, kuptimi i vërtetë i të cilit mbetet i paditur për ne. Provat etimologjike të këtij lloji zvetënohen nganjëherë në zhongllime të holla, po të kota me ligje fonetike e me rrënjë fjalësh e sufikse indoevropianë, të cilët më keq ngatërrojnë se sqarojnë". V. Beshevliev, *Zur Deutung der Kastellnamen in Prokops Werk „De adificiis“* (1970) 4.

<sup>11</sup> Revue roumaine de linguistique X (1965) 105 v., Actes du premier Congrès international des études balkaniques et sud-est européennes VI (1968) 43, Studia albanica VII 1 (1970) 166.

<sup>12</sup> Archiv f. slav. Philologie XV (1893) 98 v., Die Romanen in den Städten Dalmatiens I (1901) 13 v., Geschichte der Serben I (1911) 38 v., 49, 152. Illyr. — alb. Forschungen I (1916) 66 v. — Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich Während des Mittelalters (1924) 13. — Byzanzion VI 371, Z. f. slav. Philologie LIV (1934) 179, Z. f. Ortsnamenforschung VII 34 vv. — Beiträge zur Völkerkunde Osteuropas V (1932) 160 v., me vërejtjet e B. Saria-s Südost-Forschungen XII (1953) 15. v.

Juglindore, dhe bën kështu të shpjgueshëm forminin dhe vazhdimin e shqipes në këto anë.

Në çështjen me të cilën po merremi këtu, dihet se janë përfaqësuar dy drejtime kërkimi. Sipas njërit drejtim gjuha shqipe e ka vendin në truallin e saj të sotmin që prej kohës së vjetër. Sipas tjetrit, bartësit e saj, në atë epokë ose më vonë, kanë shtegtuar e kanë zënë vend në vendbanimet e sotme duke ardhur prej një treve më në lindje, përkatësisht më në veri. Le t'i shqyrtojmë këto teza në vijat e tyre kryesore dhe në përfaqësuesit kryesorë, para se të marrim vetë qëndrim ndaj tyre.

Për brezat e mëparme të dijetarëve, të cilat kanë marrë mjaft parasysht rrethanat historike, shqiptarët janë autoktonë. Kështu Johann Thunmani, nga fakti që ai në historinë e tyre nuk gjen ndonjë gjurmë të një imigracioni më të vonë, sheh në ta fqinj të e stërmoçëm të grekëve dhe të nënshtruarit e Romës së vjetër.<sup>13</sup> Edhe në paraqitjen e shtjelluar të kësaj qështjeje në veprën e Martin Leakut,<sup>14</sup> këtij autori mendimi i një tradite gjuhësore të pandërprerë në Shqipëri qysh prej kohës së vjetër shihet se iu duk aq i vetëkuptueshëm, sa që nuk hyri fare në shqyrtimin e mendimit të kundërt. Ashtu edhe Xylanderi flet ndër të tjera për ruajtjen e vendbanimit të popullit që prej kohës që s'mbahen mend.<sup>15</sup> Po si themeluesi i vërtetë i këtij drejtimi shkencor do të shikohet J. G. v. Hahni. I pajisur me njohuri më të mira rreth gjendjes historike e gjuhësore të vendit se paraardhësit e tij, ky dijetar i përvishet problemit në mënyrë të gjithanshme me mjetet që kishte në dorë, ndonëse këto mjete në kohë të tij ishin mjaft të paka, duke vepruar ai mu në prak të gjuhësisë krahasimtare që sapo lindte. Hahni nisat pikësëpari nga çështja që shtron dija edhe sot e kësaj dite, që d.m.th. shqiptarët a rrjedhin prej banorëve të lashtë të vendit, apo janë të ardhur në preiodën historike ashtu si sllavët, dhe pas një kërkimi të thelluar arrin në përfundimin që të parët e tyre kanë zënë viset e sotme të popullit shqiptar që në kohë të remakëve e të helenëve. Ana e fortë e Hahnit, më shumë se në njohuritë e thella që kish për lëndën, qendron në punë të metodës. Historikisht ai nisat nga fakti i theksuar më parë te Thunmani, që për Shqipëri nuk njihet ndonjë imigrim përveç dyndjes sllave. Gjuhësisht ai merr e heton përkimet e të dhënave që kemi nga koha e vjetër me gjendjen e sotme, e sidomos ai — me një mënyrë gati moderne — hyn në krahasimin e nomenklaturës gjeografike të lashtë të vendit me të renë, e aty veqanërisht, në çështjen se cilët emra gjeografikë të vjetër janë ruajtur si apelativa në gjuhën e sotme, i bindur sikurse ishte me të drejtë, që ekzistenca e emrave të tillë është një argument i parrëzueshëm për kontinuitetin. Ndër këta emra gjenden tek ai barazime të tilla si *Delmatia: delme dele, Dardania: dardhë, Dimallum: di „dy”* edhe *mal, Vendum: vend*, të cilat që atëhere janë bërë pronë e përbashkët dhe e qëndrueshme e dijës.<sup>16</sup> Në një vepër të mëpastajmë ky dijetar përfshiu po me këtë frymë objektive edhe trevën dardane në këtë vend të lashtë të të parëve.<sup>17</sup>

<sup>13</sup> Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker (1774) 245 v.

<sup>14</sup> Researchen in greece (1814) 237 vv.

<sup>15</sup> Die Sprache der Albanesen oder Schkiptaren (1835) 318.

<sup>16</sup> Albanesishe Studien (1854) 213 vv.

<sup>17</sup> Reise von Belgrad nach Salonik, botim i dytë (1868) 36 vv.

Kjo teori zotëroi për shumë kohë, dhe ajo edhe më vonë, gjer në ditët tona, ka gjetur përfaqësuesit e saj. Një modifikim bëri aty N. Jokli, në mënyrë që, për disa arësye gjuhësore, të cilat do të jepen më poshtë, ai nga vëndbanimi i hershëm i shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik, përjashtoi Bregdetin Adriatik dhe veriperëndimin e trevës së sotme, dhe atë vëndbanim e vendon në verilindjen më anësore të trevës gjuhësore të sotme, në viset e Dardanisë së vjetër, afërsisht në krahinë të qytetit Naissus, i cili edhe sot nuk është fort larg nga skanjet e kësaj treve gjuhësore, dhe ku trajta e sotme e emrit Nish, dëftoi traditën gjuhësore shqiptare. Ndërsa kështu sipas mendimit të tij vëndbanimi i shqiptarëve të sotëm nuk përkon krejt me vendin e të parëve të tyre në kohën e vjetër, ky njohës i shqar e shqipes, më vonë, nëpërmjet një zhvillimi vetiak të brendshëm („dies diem docet”), në kundërshtim me tezat e G. Weigandit, A. Philippides dhe A. M. Selishçevit, të dala në atë ndërkohë, arrin në përfundimin që të parët e shqiptarëve qysh në kohën pararomake banonin në Gadishullin Ballkanik përbrenda sferës së kulturës greko-romake dhe që shqiptarët në çdo rasë që në kohën latine, edhe pse nga mbarimi i saj, duke ardhur prej visesh më në lindje, kishin arritur në trevën e Prevalitanës, pra në pjesën veriperëndimore të vendit të sotëm të tyre, në mënyrë që sllavët, kur u shtynë në viset bregdetare të Shqipërisë Veriperëndimore, gjetën aty një popullsi shqiptare. Ky mendim gjen shprehjen e tij gjuhësore në krahasimin e emrave të sotme të disa lumenjve, me trajtat që dihen nga koha e vjetër, si *Dri Drini: Drinus, Mat Mati: Mathis* të Vibius Sequester, me përfundimin „që këta emra që në kohën e vjetër gjer në ditët e sotme kanë qenë pa ndërprejje në gojën shqiptare dhe që vetëm gjuha shqipe ka mundur t’u japë trajtën që kanë sot”.<sup>18</sup> Sikundër shihet, ky dijetar në rrymë të vjetve ka modifikuar dukshëm mendimin e tij, duke treguar që treva gjuhësore e shqipes në kohën antike puqet për një pjesë të mirë me trevën e sotme. Me këtë ai kthehet te mendimi i kontinuitetit të habitatit shqiptar që prej kohës së vjetër gjer në ditët e sotme, mendim që e pat shprehur shumë vjet më parë.<sup>19</sup> Ndërkaq mendimi i këtij dijetari për djepin dardan u rrok nga anë të ndryshme dhe u çua më tej. Kjo vlen sidomos për E. Durham, e cila që më parë vërejti se në sllavishten jugore edhe në shqipen janë shumë të shpeshta emrat e viseve nga emra bimësh,<sup>20</sup> dhe për P. Skokun e H. Bariçin, të cilët shtuan dhe *Scupi: Shkup e Astibos: Shtip*, si zhvillime të kryera pas ligjeve fonetike të shqipes. Nga lagjja e historianëve pastaj, G. Stadmüller, për arësye historike, gjuhësore dhe të gjeografisë së qarkullimit rrugor, arriti në mendimin që hapësira jetësore e popullit shqiptar për kohën romake bizantike të hershme do venduar, po në trevën e sotme, veçse vetëm në një pjesë të kësaj, d.m.th. në katërkëndshin midis fushës bregdetare të Shqipërisë së ulët, luginës së Shkumbinit, luginës së Drinit të Zi dhe luginës së Drinit të Bardhë, me krahinën e tij si qendër e tij.<sup>21</sup>

<sup>18</sup> Për fillimin e mendimit të Joklit khs. Reallexikon der Vorgeschichte I (1924) 85 v. e 91 v., Balkan-Archiv IV (1928) 201 v., IF 46 (1926) 363, 50 (1932) 34 v. e 41 v. Slavia XIII (1934—35) 286 vv., 627 vv., Studia albanica I 1 (1964) 48 vv. Ky artikull i fundit, sikundër kam vërtetuar vetë në vendin e cituar, është i vjetëve 1933—34.

<sup>19</sup> Albanisch (1917) 122

<sup>20</sup> M a n 23 (1923) 39 vv.

<sup>21</sup> Z. F. Ortsnamenforschung IV (1928) 205, Glasnik Skopskog naučnog društva XV—XVI (1935—36) 301, Revue intern. d'ét. balk. I (1934) 9, Osnovi romanske lingvistike I (1940) 132. — Hymje në historinë e gjuhës shqipe (1955) 49, Lingvističke studije. Khs. edhe C. Tagliavini

Në këtë çështje kaq të diskutuar, mendimet e dijetarëve të ndryshëm largohen mjaft nga njeritjetri. Rruga që çelën C. Pauli<sup>22</sup> e H. Hirt<sup>23</sup> e që rrahën dhe disa të tjerë dijetarë, duke ndarë shqipen, për arsëye të fonetikës historike, prej ilirishes dhe duke e venduar të trakishtja, pati për pasojë që vendi i formimit të kësaj gjuhe u çvendos më në lindje të territorit të sotëm. Kështu S. Puscariu<sup>24</sup> u përpoq të mbështeste me argumente gjuhësore mendimin e V. Parvanit, që shqiptarët në kohën midis shekullit të 3 e të 6 të erës sonë, hynë, si paraardhës të sllavëve, prej verilinjes në jugperëndim, gjatë naltësive të Karpateve, nëpër Transilvani, shkallë-shkallë, si barinj shtegtarë, në viset jugore dhe pastaj në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, mendim që autori i tij nuk e mbështeti më tej me argumente historike. Ndërkaq, argumentet e Pascariut, pas objeksioneve të L. Spitzerit,<sup>25</sup> nuk u dëftuan dhe aq të forta. Pascariu vetë më vonë ndryshoi mendim në lidhje me këtë çështje.<sup>26</sup>

Të tjerë dijetarë i bien shqiptarët të ardhur prej visesh më në veri në trevën e sotme. Kështu K. Jireçeku është i mendimit që ilirët gjysmë të romanizuar, të parët e shqiptarëve, gjatë shtegtimeve të popujve, prej malësive midis Dalmacisë e Danubit u shtynë për në jug.<sup>27</sup> Ashtu afërsisht edhe A. Philippide vendbanimin e hershëm të shqiptarëve e vendon „diku në veri”, në malësinë e anëve të Bosnjes midis lumenjve Vrbas dhe Drina, ku pas mendimit të tij nuk janë gjetur mbishkrime latine, dhe për një kohë më të lashtë të çon edhe më në veri, në Panoni, duke i marrë shqiptarët për panonas.<sup>28</sup> Pas A. M. Selishçevit bile shqiptarët janë të ardhur në viset e sotme pas sllavëve,<sup>29</sup> një mendim ky që në kohët e fundit I. Popoviçi është përpjekur ta mbështetë me argumente gjuhësore.<sup>30</sup>

Ndër dijetarët që janë marrë me çështjen që kemi përpara, G. Weigandit i bie pa tjetër merita që e shtroi këtë mbi një bazë të gjerë dhe duke e shqyrtuar në hollësi, veçse vërtet në mënyrë të njëanshme gjuhësore. Argumentet kryesore të Weigandit kundër autoktonisë shqiptare janë, sikundër dihet, këto: 1. Emrat latinë të vendeve paraqesin jo trajtën fonetike të shqipes, po trajtën latine-dalmate të vjetër, 2. Terminologjia e lundrimit dhe e peshkatarisë është e gurrës së huaj; 3. Nuk ka gjurmë të një ndikimi dalmat të vjetër prej një kohe më të vonë në shqipen, po ka gjurmë të italishtes, veçanërisht të venecianishtes; 4. Në shqipen ka disa fjalë të cilat dëshmojnë si fjalë të trakishtes; 5. Një varg emra personash e vendesh të Trakisë e të Dakisë gjejnë shpejzëgjim me anë të shqipes; 6. Po të kishin banuar shqiptarët gjithmonë në Shqipërinë e sotme, emrat e vendeve që dihen prej kohës së vjetër, duhej të kishin pësuar edhe ato zhvillimet fonetike të shqipes; 7. Shqiptarët nuk zihen ngoje para shekullit të 11, megjithëse gjithë kjo trevë përmendet në plot dokumenta edhe

n in, *Le parlate albanesi di tipo ghego orientale* (1942) 12, *Stetificazione del lessico albanese* (1965) 21 vv.

<sup>22</sup> *Leipzigiger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa V* (1941) 58 vv., *Forschungen zur alb. Frühgeschichte* (1841), *ribotim i zgjeruar* (1966) passim, *sidomos f. 84, 118 vv.*

<sup>23</sup> *Eine vorgriechische Inschrift von Lemnos. Altital. Forschungen II* (1894) 200.

<sup>24</sup> *Festschrift für H. Kiepert* (1898) 181 vv.

<sup>25</sup> *Zur Rekonstruktion des Urrumanischen. Z. f. rom. Phil. XXXI* (1910) 61 vv.

<sup>26</sup> *Mitteil, des Instituts für rum. Sprache an der Universität Wien I* (1914) 292 vv. Khs. dhe *Philippiden, Originea Romnilor I*, 694.

<sup>27</sup> *Limba romana I* (1940) 271.

<sup>28</sup> *Geschichte der Serben* (1911) 152, *Illyr. — alb. Forschungen I*, (1916).

<sup>29</sup> *Originea Romnilor I* (1925) 515, *II* (1927) 587, 770 vv., 799 vv.

<sup>30</sup> *Shavianskoe maselenie v Albanii* (1930) 49 v., 73 v.

në lidhje me popullsinë, si do të mund të kishin mbetur shqiptarët pa u përmendur, po të kishin qenë në vend?; 8. Marrëdhënjet rumuno-shqiptare të burimit jolatin dëshmojnë për bashkëjetesën dikur të shqiptarëve e të rumunëve; 9. Në gjuhën rumune ka elemente latine, trajta e të cilave vetëm ashtu shpjegohet, që ato kanë hyrë atje nëpërmes të shqipes; 10. Elementët latine të shqipes e të rumanishtes përqasen në një mënyrë aq të dukshme, sa duhet të jenë formuar në kushte kulturalë, vendore e gjithë shtete të barabarta; 11. Folklori i shqiptarëve ka disa përkime me atë të rumunëve, të cilat nuk shfaqen te bullgarët e të serbët, që rrojnë midis atyre dy popujve; 12. Kënga paraqet përkime që bien në sy.<sup>31</sup> Përfundimi është ky, që shqipja u zhvillua në një vend ku u formua dhe rumanishtja, pra — pas hullisë së Tomashekut — përbrenda trekëndshit Nish-Sofje-Shkup.

Kjo tezë ka parë dhe miratim dhe refuzim. Refuzim ndër të tjerë të Joklit,<sup>32</sup> kundërshtim të arsyetuar e në formë të shtjelluar te J. Erdeljanoviç,<sup>33</sup> W. Cimoehowski,<sup>34</sup> dhe H. Mihaescu.<sup>35</sup> Miratim te një varg dijetarësh, emrat e të cilëve mund të kalohen këtu, ngase vështrimi i tyre, në argumentin dhe në rezultatin, në thelb është identik me atë të Weigandit. Te këta ka mbetur pa u vënë re mendimi i A. Meillet-së, që shqipja pas gjasëve është vazhdimi i një gjuhe që ka qenë folur qëmoti në trevën e sotme.<sup>36</sup>

## II

Po të synohet të arrihet te ky problem në një sintezë, pikësëpari duan shqyrtuar pikëpamjet e gjertanishme me kritikë në frymë objektive, dhe duan diskutuar bazat e tyre teorike, që pas kësaj mbajtje qëndrimi të bëhet një përpjekje për t'i mbledhur faktet në një sistem.

Nga një vështrim përmbledhës i këtyre pikëpamjeve mendojmë se del pikësëpari që ka këtu një farë kundërshtie midis historianëve dhe gjuhëtarëve. Historianët ndërkaq, me shumë pak përjashtime, si duket, për mungesë burimesh të hershme, këtë çështje—jo pa një farë resignacioni — me kohë ua lanë në dorë gjuhëtarëve. Këta i hynë kësaj detyre me metodat e tyre vetiake e me mjetet që kishin në dorë, veçse ata në atë mes shpesh i lanë t'u zhduken prej sysh të dhënat gjeografike-historike, dhe kështu nganjëherë u larguan nga trualli i realitetit. Me këtë rrugë u arrit shpesh në një qëndrim të njëanshëm në shtrim të çështjeve dhe në zgjidhje të tyre. Po t'u shtojmë këtyre qëndrimet subjektive që vihen re te disa dijetarë, e krahas me këto edhe disa tendenca jashtë shkencës e të bëra zakon te ta, do të pranohet që në krahasim me brezat e përparme të dijetarëve, objektiviteti shkencor vise-vise është pakësuar disi, dhe që kështu krahas me përparimin e pamohueshëm, ka pasur edhe ecje

<sup>31</sup> Z. f. slav. Phil. XXVI (1958) 301 vv., Geschichte der serbokroatischen Speache (1960) 79 v., 157 vv.

<sup>32</sup> Balkan-Archiv III (1927) 227—251. Në formë të shkurtuar edhe më parë, Ethnographie von Makedonien (1924) 11 vv.

<sup>33</sup> IJ XIII VII 181.

<sup>34</sup> Makedonski Srbi (1925) 19 v.

<sup>35</sup> Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Sëria Shk. Shoq. XII (1958) Nr. 2, f. 37 vv.

<sup>36</sup> Revue des études sud-est européennes IV (1966) 342 v.

mbrapa, një dukuri që, sikundër dihet, nuk mungon krejt në fushën e shkencave shoqërore.

Pikësëpari, mendimit mjaft të përhapur që treva gjuhësore e shqipes u ka shpërngulur në periodën historike prej një vendi më në lindje ose më në veri në këtë të tanishmin, i mungon baza historike. Do të ishte një dukuri përjash-timore, që një shkullje (emigrimi) e ngulim i një popull të tërë, i kryer brenda sferës së botës romake e greke e në dritë të plotë të historisë, të ketë ndodhur pa u vënë re prej historisë. Mendimi që ka lidhje me këtë tezë, që kemi të bëjmë aty me një popull barinjsh shtegtarë, lëvizjet e të cilëve si të tilla që ishin, nuk tërhoqën vëmendjen e bashkëkohasve, jo vetëm që nuk është mjaft real nga pikëpamja ekonomike e përgjithshme, po nuk pajton as me faktet kulturhis-torike e sociale konkrete, mbështetet prandaj poaq më një vështrim të një-anshëm sa edhe gjykimi i gjendjes mesjetare. Gjuha e vendit na jep të tilla dëshmi për historinë e popullit, që do të gjendemi më afër realitetit historik, kur të pranojmë pranë ekzistencës së elementeve që rronin në transhumancë edhe elemente ndejtare, pranë barinjve edhe bujq që lëvronin arën, pranë katun-darëve dhe qytetarë, pranë luftëtarëve dhe zejtarë paqesorë. Meqë këtu nuk është vendi për të vërtetuar këtë në veçanti, le të mjaftojë shënimi, që ndikimi latin, mbi dëshminë e gjuhës, këtu — afërsisht ashtu si në Dalmaci — ka pasur më fort një karakter urban (qytetar) sesa rural (fshatar); në kundërshtim me Rumaninë, rethanat e së cilës shtjellojnë Puscarin<sup>37</sup> me Mihaescun.<sup>38</sup> Kjo kundërshti ndaj Rumanisë vërehet dhe në gjuhën kishtarë, duke mbizotëruar në shqipen elementin latin roman e pjesërisht dhe elementi grek-bizantin, po duke munguar krejt në mënyrë të shënueshme, elementi sllav, gjë që dëshmon për një jetë qytetare me organizim kishtar të formuar, në kohën e ardhjes së sllavëve në këto anë.<sup>39</sup>

Gjuhësisht problemi ynë në analizë të fundit përmbledhet në këtë pyetje: A ka gjurmë të lashta të shqipes në Gadishull të Ballkanit, dhe në qoftë se po, ku ka? Sikundër u tha edhe më lart në këtë mes nuk vijnë në vështrim dëshmitë e shkruara të kësaj gjuhe, të cilat janë të një kohe shumë më të vonë. Në këto rrethana duhet t'i sillemi një materiali më të mocëm, i cili jo vetëm na fal një formë gjuhësore më të përparme, po na jep të dhëna edhe për shtresimin gjeo-grafik dhe për vendin e përhapjes së bartësve të gjuhës në kohët e para. Aty vijnë në vështrim marrëdhënjet e vjetra të huazimit me gjuhët fqinje, po mbi të gjitha emrat e lashtë vetiakë, sidomos emrat e vendeve. Emrat e vendeve, më autoktonë e të qëndrueshëm e më të lidhura me hapësirën e truallin se emrat e personave, që janë më të lëvizshme e më të shtruarra modës së kohëve, dihet se arrijnë shpeshherë në një situatë gjuhësore shumë më të vjetër se ajo që dësh-mohet me burime të shkrimit; ato paraqesin si të thuash pika të ngulëta brenda lëvizjeve të popujve e të gjuhëve, prandaj ndihmojnë në rindërtimin (rekonstrukcionin) e situatave të mëparme. Këtu ndërkaq do shënuar se një studim shken-cor i këtyre emrave lidhet me respektimin e disa parimeve të caktuara. Pikësëpari duhet afruar fakteve pa paragjykime, dhe vetëm pas një vrojtimi e kons-

<sup>37</sup> „There is no reason for holding that it come from lhrace and it probably is the continuation of a language, which from early times was spoken in this area”, *Encyclopaedia Britannica* XIV (1929) 514.

<sup>38</sup> *Limba româna* I 354 v.

<sup>39</sup> *Limba latina în provinciile dunarene ale imperiului roman* (1960) 43.

tatimi objektiv të tyre, duke u nisur prej sosh, mund të kalohet në ndërtim teorish. Aty pastaj nuk duhet vepruar pas mënyrës së vjetër skolastike, me shtrim aprioristik disa të vërtetash, të cilave duhet t'u përshtaten faktet. Ngaqë, pastaj, emrat topikë të një treve të caktuar gjenden pranë e pranë jo pa asnjë lidhje në mes të tyre, po si pjesë të një tërësie më të madhe të një sistemi, ata në pikëpamje metodike duan vështruar jo të izoluar, po brenda lidhjes teritoriale e gjuhësore që kanë. Përveç kësaj është e domosdoshme që të kihet parasysh shtresimi kronologjik, duke dalluar emrat e hershëm nga ata më të rinjtë. Që së fundi materiali nuk do të përpunohet pa kritikë; kjo nuk është nevoja të theksohet më tepër.

Duke iu sjellë prej këndje pyetjes që u shtrua më sipër, vihet re se as në Panoni, as në Dalmaci ose në Bosnjë, as në Transilvani nuk gjenden kund gjurmë të lashta të shqipes. Edhe vetë për këtë arsye — të tjera do të jepen më poshtë — në kundërshtim me mendimet e dijetarëve të përmendur më lart, përjashtohen përgjithësisht pjesa veriore si dhe pjesa lindore e Gadishullit Ballkanik si vend i formimit të shqipes, ku natyrisht duan shtuar nga ana jugore e tij viset e Greqisë. Duke zbatuar këtë mënyrë procedimi të përjashtimit ose eliminimit (për *exclusionem*), në kombinim edhe me atë të kufizimit, ngushtimit (per *restrictionem*), më një anë duke lënë jashtë një nga një ato vise që nuk vijnë në vështrim, më anë tjetër, duke ngushtuar sa shkon e më shumë territorin që vjen në vështrim pozitivisht për këtë punë, arrihet në një trevë gjeografikisht mjaft të hapët të anës ballkanike perëndimore. Brenda kësaj treve; ndër të tjera *Naissus-Nish*, *Scupi-Shkup* e *Astibos-Shtip*, sikundër u shtjellua lart, dëshmojnë që Dardania bashkë me viset kufitare të Maqedonisë e të *Peonisë* bëjnë pjesë në territorin e formimit të shqipes. Po të sillmi nga treva gjuhësore që shtrihet brenda kufive të Shtetit të sotëm shqiptar, e të pyesim nëse qëndron mendimi se „shqiptarët nuk kanë trashëguar asnjë element kulture (si p.sh. emra *personash ose vendesh*) të kohës antike”<sup>40</sup> pamja paraqitet si vijon. Duke nisur me Veriun, pikëpamja e N. Joklit, që mendimi se emri i qytetit *Shkodër*, *Shkodra* qysh prej kohës pararomake gjer sot të ketë qenë pa ndërprerje në të folët shqip, nuk pajton me rezultatet e fonetikës historike të shqipes, për punë të ballit të fjalës dhe të grupit konsonantik në trup të fjalës, kjo pikëpamje ruan vlerën për periodën e caktuar prej autorit të saj, porse nuk prek problemin tonë në pikëpamje kronologjike. Çështje e vendit të formimit të shqipes shtrohet prej nesh për fazën antike të shqipes, e për atë periodë gjuhe barazimi *Scodra*: shq. *Shkodër* pajton më së miri me rregullat fonetike të shqipes; për ballin e fjalës khs. gr. e vj. (trak) *skalme*: shq. *shkallme* „shpatë”, *skariphos*: *shkarpë* „karrthje”, lat. *scammum*: *shkamb* „shkëmb; stol”, për grupin konsonantik në trup fjale lat. *barathrum* prej gr. së vj. *barathron*; shq. *balladër* „ujvarë”, lat. *chersydrus* prej gr. së vj. *khérsydros*; shq. *kulshedër*. Për arsye kronologjike nuk mund të pajtohemi as me mendimin e këtij dijetari, që toponimet e llojit *Rogami*, *Rogame* me ruajtjen e -g- së në trup fjale flasin kundër një tradite gjuhësore shqiptare të pandërprerë; këto toponime janë formime sekundare të shqipes, të përfuara relativisht vonë me zgjerim sufiksial, kështu që ruajtja e guturalit të brendshëm shpjegohet mirëfilli.

<sup>40</sup> Khs. dhe autorin. *Revue roumaine de linguistique* VII (1962) 168, X (1965) 114, *Die Sprache* XIII (1967) 47.

Përsa u përket toponimeve të anëve të tjera të Shqipërisë, aty së pari do mbajtur qëndrim në një formë disi më të shtjelluar ndaj tezave të G. Weigandit që u zënë ngojë më sipër, veçse pa hyrë në çështjet etnografike që preken prej tij. Weigandi, i cili ka merita të pamohueshme për studimin e gjuhëve ballkanike, ndër to edhe të shqipes, në këtë çështje ka rënë në pikëpamje metodike në këtë gabim, që nuk përfill sa duhet rendin historik të toponimeve. Përveç emrave që dihen prej lashtësisë, për të cilat, në lidhje me vazhdimet moderne të tyre, mohon kontinuitetin gjuhësor shqiptar, ai merr për dëshmi dhe një shumicë emrash sllavë lokalitetesh, sidomos katundesh prej Shqipërie Veriore e të Mesme, pa marrë parasysh se në Shqipëri, si dhe përgjithësisht në Gadi-shullin Ballkanik, si një zonë e përszkuar gati kurdoherë prej lufrash, ngulimet fshatare janë jetëshkurtëra mbase më fort se gjetkë dhe se prandaj edhe emrat e tyre nuk janë dhe aq të vjetër. Për këtë arsye, emrat e këtij lloji, që në pjesën më të madhe janë të mesjetës ose të kohës së re, për problemin që shtrohet këtu nuk vijnë fare në vështrim. Nuk vijnë në vështrim as gjithë ata emra krahinash, qytetesh, lokalitetesh e lumenjsh, të formuar me lëndë vendi, si *Lini, Këlmënd, Dukagjin, Shalë, Shosh, Kir, Anamal, Temal, Iballe, Lumë, Krumë, Lurë, Dejë, Mirditë, Bulgër, Kthellë, Blimisht, Kallmët, Giadër, Thumanë, Krue, Tomadhë, Përrenjas, Gramsh, Shpat, Lushnje, Fier, Labëri, Kuç, Prevezë*, të cilat vërtet janë të një farë moshe, porse pas gjithë gjasësh nuk janë të kohës antike dhe as nuk dalin në burimet e asaj kohe. Në vështrim vijnë kryesisht emrat e qyteteve, të maleve e të lumenjve që dëshmojnë për kohën antike ose për periodën e mbarimit të saj, mësa një krahasim i trajtave të tyre të hershme me trajtat e vendit që janë sot në përdorim, tregon një zhvillim në harmoni me rregullat e zhvillimit fonetik të shqipes, apo jo. Prej vjetësh kam arritur në këtë përfundim, që ky zhvillim ka shkuar në vështrimin e ligjeve fonetike të shqipes, dhe vetëm me ndërmjetësinë e kësaj gjuhe,<sup>41</sup> dhe këtë desha të shtjelloj këtu, sa më shkurt që të jetë e mundur, edhe një herë, pa hyrë përgjithësisht në një refuzim të mendimeve të kundërta. Po shënojmë më parë që emrat e kohës antike, sikundër dihet, na shfaqen në trajtë greke ose latine, porse kjo nuk paraqet kurdoherë refleksin besnik të trajtës së emrit të përdorur zakonisht prej popullsisë së vendit. Sidomos gjuha e administratës romake—afërsisht ashtu siç ndodhte më vonë në administratën osmane — nuk duket t'i jetë mbajtur fort trajtës lokale të toponimeve, prandaj këto nuk i gjurmohet dot mirë për nga ana e trajtës fonetike, sidomos përsa i përket akcentit.

Duke nisur nga toponimet me burim jolatin dhe duke shkuar prej Veriu në Jug e në lidhje me reflekset e Naissus, Scupit e Scodras që u dhanë më lart, në Veri të *Oulkinion; Ulqi Ulqin* dhe të trevës së gjuhës shqipe, na shfaqet emri i *Raguzës, Ragusium*, emërtimi i vjetër shqip i së cilës, *Rush* tregon ndërmjetësinë e gjuhës shqipe. Më në jug, emri i qytetit që greqisht jepet si *Lissos* e latinisht si *Lissus*, e që shqip është *Lesh*, paraqitet me një formë, e cila pajton kryekrejt me *shpesh* prej lat. *spissus* „i shpeshët”. *Qafa e Prushit*, që gjendet më në Veri mund të jetë vijim i emrit të Pirustëve (*Pirustae, Perustae*, pas një mendimi të A. Saraçit), me një zhvillim të grupit *st në sh* si te fjala *teshë* prej lat. *testa* „guaskë, gurriç, rrashtë, kokë”. Aty mbase hyn edhe *Candavia*:

<sup>41</sup> I. I. Russu, *Die Sprache der Thrako-Baker* (1969) 206. Më butë disi („gati askund”) A. Meyer, *Die Sprache der alten Illyrier I* (1957) 14.

ipeshkvia mesjetare *Chunavia*, me ndërrimin *nd: n* që është i rregullt në shqipen. Më në Lindje, emri i malit që tek autorët grekë jepet si *Skardos*, *Skardon*, te romakët si *Scardus mons*, u ka zhvilluar sipas ligjeve fonetike të shqipes në të sotmin *Shar*, një emër ky i cili prej shqipes kaloi dhe në të tjerat gjuhë ballkanike duke përfshirë aty edhe turqishten. Emrat e lumenjve *Drinus*: *Drî Drini* dhe *Mathis*: *Mat* u përmendën më lart, prandaj nuk është nevoja të rishqyrtohen. Një zgjerim i vjetër i shqipes me sufiks *-n*, *Skampin-*, latinisht dëshmuar si *Scampinus*, një rrjedhojë e *Scampis* të kohës antike (Elbasani i sotëm), në gojën e shqiptarit dha rregullisht *Shkumbî Shkumbini*, me errësimin e *ë-së* parateksores në *u* në dialektin përkatës të Shqiprisë së Mesme, dhe me asimilimin të grupit *mb* në *m* në gegërishte. Më poshtë në jug, emri i qytetit bregdetar të Vlorës, greqisht te Ptolemeu *Aulon*, që po të kishte pasur një ndërmjetësi të sllavishtes pas fjalëve të vetë Weigandit duhej të kish përfunduar në një *Valin* ka dhënë *Vlonë*, *Vlorë* pas ligjeve fonetike të shqipes, me aferezë të rregullt të *a-së* e me rotacizmin e mëpastajmë të toskërishtes. Fare në Jug, forma *Çam*— e *Çamërisë* na jep shembëllin e emërtimit të një krahine nga lumi që e përshkon: aty, sikundër vuri re prej kohësh M. Lacke,<sup>42</sup> u ka ruajtur emri i lumit *Thyamis* të kohës së vjetër, i cili ndërkaq në greqishten e re nuk njihet, po është zëvendësuar me emrin *Kalamas*.

Duke kaluar tek emrat treqroësh të vendeve, aty dalin ndër të tjera *Dyrrhachion Dyrrhachium*: shqip *Durrës*, *Isammus fl'* (te Vibius Sequester): shq. *Ishëm*, *Ishm* (lumë që derdhet në Adriatik, në veri të Durrësit, dhe lokalitetet me të njëjtin emër), ku duan shtuar dhe *Drivastum*: shq. *Drisht* me *Polatum*: *Pulët* sot *Pult*, të cilat dëshmohen me burime mesjetare të hershme. Duke bërë tonin mendimin e shprehur prej H. Krahes, që ilirishtja, ashtu si gjuha gjermanike e përbashkët, si keltishtja dhe si gjuhët italice, ka zbatuar një theksim inicial (nistor),<sup>43</sup> do të mendohet që këta emra në të folët e vendit kanë qenë shqiptuar *Durrach*, — *Isamn*, — *Drivast*, — *Polat* — *Pulat* etj., vazhdimet e drejtëpërdrejta të së cilave ruhen në format e emrave të tyre të sotëm. Te *Drivastum*: *Drisht* këtë zhvillim e pat vënë re më parë dhe P. Skoku.<sup>44</sup> Për *Durrës* W. Cimochoviski — në kundërshtim me Skokun, i cili këtë emër e nxirte prej një sllav. të hershme *D њ а њ б* si formë e përpamë e të sotmes *Draç*<sup>45</sup>, ashtu si edhe unë vetë, nisem nga kjo, që kjo formë është përfutur nëpër një zhvillim të pandërprerë të emrit antik, pararomakdorik të qytetit.<sup>46</sup> Ai mendon pra, në një mënyrë plauzible, që ky zhvillim është përshkruar nëpër shkallët *gr-dor*. *Durrachion*: ilir. *Durrakium*: shq. *Durrëç*: *Durrës*. Tek *Isammus*, një trajtë fjale e zgjeruar me një element *-mn-* ashtu si p.sh. emri i lumit *Sedamnos* në Kretë,<sup>47</sup> në gjuhën shqipe *mn* u asimilua rregullisht në *m*, ashtu si te *gjumë* përkundrejt lat. *somnus*. Në këtë grup toponimesh treqroëshe që u shqyrtua

<sup>42</sup> Albanologji (1947) 42 vv., Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Ser. Shk. Shoq. XII (1958) Nr. 2. f. 54 vv., XVI (1962) Nr. 4 f. 122 v., 136, VII. Congresso Internat. di Scienze Onomastiche (1961) 241 vv., Revue (roumaine) de linguistique VII (1962) 162 v., X (1965), 104 v., Actes du premier Congrès des études balkaniques et sud-est européennes VI (1968), 44, Studia albanica VII I (1970) 162 v., 167.

<sup>43</sup> Recherches in quelle (1814) 13.

<sup>44</sup> Indogermanische Sprachwissenschaft (1943) 34. Didi ashtu më parë edhe Shoku, Arhiv za arb. starinu I (1923) 10 vv.

<sup>45</sup> Arhiv za arb. starinu 10 v.

<sup>46</sup> Po aty II (1925) 111 vv.

<sup>47</sup> Lingua Posnaniensis VIII (1960) 135 vv.

këtu, hyn, nga pikëpamja territoriale si dhe nga pikëpamja tipologjike, dhe emri i lashtë i shqiptarëve, *arbën*, *arbër*, në lidhje me *Albanoi*-në e njohur të hartës botërore të Ptolemeut, një emër ky, i cili, në pajtim me gjendjen që u shtjellua këtu, në shqiptimin lokal do të ketë qenë shqiptar *Albanoi* me theksim inicial. Kundra H. Hirtit, H. Pedersenit ka parashtruar që ky emër, për arësye të *b-së* (jo *v*), nuk mund të jetë marrë prej greqishtes aty në një kohë më të vonë, porse duhet pa tjetër të jetë i vjetër te vetë shqiptarët.<sup>48</sup> Po emri ndërkaq, për punë të *r-së* (jo *l*), nuk mund të jetë as i burimit latin ose roman, dhe për punë të *arb-* (jo *rab-*) as i burimit sllav. Ai buron prej emrit vendës të kohës antike, i cili i përket po asaj hapësire gjeografike ku hyjnë edhe Drivastum, Isamnus, Dyrachium etj. Në lidhje me çështjen e vendit të formimit të gjuhës shqipe, vazhdimi i emrit nacional prej kohëve antike gjer më sot sigurisht nuk është pa rëndësi. Trajta bizantine *Arvanon*, së bashku me emërtimet e kombit shqiptar te gjuhët fqinje të shqipes, në këto kushte duhet të ketë rrjedhur prej kësaj gjuhe; nga trajta e serb. së vj. *Rab* рѣнъ „Shqipëria” shihet m’anë tjetër se emri i *Laberisë* nuk mund të ketë dalë, me metatezë, nga një *Albëri* sipas një ligje fonetike të sllavishtes, si kanë thënë shumë dijetarë pas hullisë së Gustav Meyerit.

Për ta mbyllur disi këtë pamje të emrave të vjetër trirrokësh në tërësinë e tyre territoriale e gjuhësore, do të shënojmë se P. Kretschmeri dhe të tjerë dijetarë pas tij, mbi dëshminë e trajtave të emrave *Brindisi*, *Otranto*, *Taranto* në italishten e sotme, përkundrajt trajtave të vjetra *Brundisium*, *Hydruntum*, *Tarentum* të dëshmuara me rrugë shkrimi, kanë ardhur në përfundimin se ka pasur një theksim inicial në trevën e mesapishtes<sup>49</sup> dhe këtë mendim në kohët e fundit A. Mayer<sup>50</sup> dhe M. Durante.<sup>51</sup> Në bazë të disa rasave interesante, e kanë shtrirë duke rrokur dhe ilirishten ballkanike. Në lidhje me shqipen po lejohem të përsëris këtu<sup>52</sup> që theksimi inicial ilir dhe rregullimi mekanik i theksit në gjuhën shqipe me parimin e shpërnguljes për në rrokjen parafundore, i konstatuar prej N. Joklit, historikisht nuk anulohet, po plotësojnë njëri-tjetrin. Ngulitja e theksit të fjalës mbi këtë rrokje në shqipen na tregon që kjo gjuhë, me bjerrjen e shpeshtë të rrokjeve fundore, gjatë zhvillimit të saj, prej theksimit inicial arriti në theksimin e rrokjes fundore duke kaluar nga një ritm daktilik i fjalës (—v v) në një ritm trokaik (—v v), sikundër dëftojnë më së qarti rasat e tipit *Isamnus: Ishëm*. Kur thuhet prandaj te A. Meyerit (II 161) se rregullimi mekanik i theksit të shqipes ka shlyer në këtë gjuhë gjurmët e lashta, dhe te Durante (f. 44) se historia e shqipes nuk njeh aspak një gjendje me theksim inicial, dhe se kjo gjuhë ka një theksim të ngulët mbi parafundoren, e cila, me zhdukjen e zanoreve dhe kontraktionet në rrokjet fundore, erdhi dhe u bë shpeshherë rrokje fundore, unë me këto mendime nuk mund të pajtohem.

<sup>48</sup> Për këtë emër. H. Krahe, *Sprache und Vorzeit* (1954) 54.

<sup>49</sup> *KL* 36 (1900) 299.

<sup>50</sup> *Glotta* XIV (1924) 90. — F. Riberzo, *Rivista indogreco-italica* XII (1928) 202, — F. Altheim, *Geschichte der lat. Sprache* (1951) 315.

<sup>51</sup> *Die Sprache der alten Illyrier* II 161.

<sup>52</sup> *Analì dell' Istituto Universitario Orientale di Napoli. Sezione Linguistica* I (1959) 1 f. 41 vv.

Punën e emrave topikë latinë e romanë do ta rrok më shkurt. Mendimi i Weigandit, që emrat topikë latinë paraqiten në shqipen jo me trajtën fonetike shqiptare, po latine-dalmate të vjetër — mendim, i cili më duket se bie dhe në një farë kundërshtimi me tjetrin mendim të tij që në shqipen nuk ka gjurmë të një ndikimi të dalmatishtes së vjetër për një kohë më të vonë — ky mendim nuk i qëndron kritikës. Po t'i këqyrim toponimet *Petrosa, Valbona, Domni, Patosa, Mallakastra, Kastrati, Surella, Oblika*, të cilat jepen aty si dalmate, nga pikëpamja e faktit të ditur që në dalmatishten zanoret e shkurtëra dhe të gjatat, në rrokje të lirë dhe të mbuluar, pësojnë diftongime të shumëllojshme, do të jetë vështirë të ia atribuojmë këto toponime dalmatishtes.<sup>53</sup> Nga që në atë gjuhë *o*-ja e shkurtër në pozicion të lirë ka dhënë *u*, në pozicion të mbuluar *na*, dhe *o*-ja e gjatë në pozicion të lirë *au*, në të mbuluarin *a*, *Valbona* e *Domni* në njerën, e *Petrosa* me *Patosa* në tjetrën anë, do të paraqiteshin me një trajtë fonetike krejt ndryshe nga që kanë në të vërtetë dhe kështu afërsisht qëndron puna, mutatis mutandis, edhe me *Oblika, Surella* etj. Dija e gjertanishme, sidomos N. Jokli, ka vërtetuar përkundrazi që emrat topikë latinë, me gjithë trajtimin e ndryshëm, të kushtëzuar me rrugë kronologjike, për arësye të ndikimit romak që zgjati më se shtatë shekuj — trajtim i pavënë në llogari të Weigandit — në gjuhën shqipe kanë shkuar plotësisht në hullinë e ligjeve fonetike. Ato kalojnë sidomos hap më hap e me forma të njëllojta me huazimet latine përgjegjëse, aq, sa shpeshherë është e vështirë të dallosh njerin element nga tjetri. Për të dhënë vetëm ndonjë shembëll, mund të përmenden *Castellum: Këshqël* pranë *kështjël, Corvinus; Kurbi, Crupta, crypta; Groftat, exsuctus; Proni qift, publica; Pukë* pranë *udhë* e *pukë* „publica via”, *rivulus: Rrjoll, subterraneum: Slurrtreja Slutrrija, fil (i) cetum; Fulqët, vinealis: Vinjall*, dy të fundit në Mat, kjo e fundit dhe në Kurbi.<sup>54</sup> Hyjnë aty edhe emrat e katundeve *Vilë, Vila*, me përhapje në mbarë vendin, që rrjedhin prej një lat. *Villa* (shtëpi në katund, çiflik), e cila nuk ka dalë në gjuhë. Këtu lind pyetja nëse toponimet e këtij lloji, të cilat nuk janë edhe të shumta, janë përdorime toponomastike elementesh latine të leksikut të shqipes, siç qëndron puna me *Gushti, Ilqet, Kallmet, Kunorë, Qelzë, Qerret, Shkortull, Vjerdhë* etj. në mënyrë pra që ata që emërtuan qenë shqiptarë, apo mos kemi të bëjmë, të pakën pjesërisht me emërtime që nuk dalin si elemente latine të leksikut të shqipes, që mungojnë aty, pra me mbeturina gjuhësore të fundit të një elementi roman të dikurshëm të vendit; Çështja e ekzistencës së vazhduar të një elementi të tillë etnik-gjuhësor, me rrjedhë prej provincialesh romakë dhe i afërt me atë të Dalmacisë, ekzistencë e pranuar nga një varg dijetarësh edhe për një kohë gjer në mesjetën e vonë, përbën një problem shkencor, i cili meriton të gjurmohet më tutje.

Nuk përbën problem, për mendimin tim, çështja e ngritur në këto kohët e fundit sidomos nga ana e I. Popoviçit, me formulimin „a sllavët a shqiptarët kanë ardhur më parë në Shqipëri”. Ky dijetar, i rrëmbyer prej vdekjes para kohe, në pajtim me Weigandin e Selishçevin e në kundërshtim me Joklin e Bariçin, duke u mbështetur në materialin toponomastik, ku disa toponime parromake e latine shfaqen me trajta sllave dhe shqiptare, vjen në përfundim që këto emra janë zhvilluar jo pas ligjesh fonetike të shqipes po në rasi të qarta

<sup>53</sup> Khs. *Studia Albanica* VII 1 (1970) 167.

<sup>54</sup> Khs. edhe me tjetër arësyetim — *Stadmüllerin, vepra e cituar f. 93 v.*

përherë nëpërmjet të sllavishtës.<sup>55</sup> Kjo çështje, për sa u tha gjer këtu, mund të thuhet se përgjegjen e ka marrë. Pa u ndaluar në hollësi dhe pa u vënë shenjë gabimeve mjaft të shumta të uatorit, këtu desha vetëm të shënoj faktin e pavënë re gjer sot, që këta emra visesh nga ana sllave janë të kufizuar në fushën onomastike, nga ana shqiptare përkundrazi paraqesin shpeshherë marrëdhënje semantike me lëndën joonomastike, me leksikon apelativ. Kështu p.sh. emri i lumit *Lim* është shq. *lym*, *lim* „baltë e lumit; tokë që sjell lumi me vete”, e cila vjen nga *lyej*. Tek lumi i Shqipërisë veriake që serbokroatisht quhet *Bojana*, trajta *Bojanë* që jepet shumëkund si emri shqip i tij, është një fjalë librash (mot savant), i cili nuk ekziston fare në gjuhë, sepse emri popullor i këtij lumi është *Bunë*, më i vjetër *Buenë*, më 1406 *Saneti Benedriti de Buena*, dhe ky shkon me *buenë*, *bujenë* *voenë* „përmytje, dërrdhazë”, një emër që ka farefisninë e vet në gjuhë dhe që është i dialekteve të Jugut. Emri *Dëjë* (Vau i Dëjës), serb. e vj. *Danb*=*Danj*-, ital. mesjetare *Danjo*, te Popoviçi shënuar si etimologjikisht i errët, del edhe në Mat, dhe nuk ka lidhje me serb. e vj. *dan* „doganë”, po shpjegohet me mjetet gjuhësore të shqipes, *dëjë* „shkririje e borës, vendi ku shkrin bora, vend i cekët në ujë, cekë”. Emri i lumit shqip *Mat Mati*, latinisht te Vibius Sequester „Mathis Dyrrachi non longe a Lisso”, serb. e vj. *Matb*, ka farefisi në fushën apelative të shqipes, sepse *mat* në geg. veriore është „breg lumi”, në arbërishten e Kalabrisë „breg deti”. Këta shembuj mjaftojnë për të formuar një gjykim për raportin historik të shoqishmë të këtyre toponimeve dygjuhëshe shqiptare-sllave, dhe për të hedhur dritë dhe mbi çifte më të reja, si *Bjeshkët e Nemuna: Prokletije, Ujmirë: Dobrovoda*, si dhe mbi disa më të lashta, si *Oulkinion: Ulqi Lcin; Drinus: Dri Drim, Dyrrachium: Durrës, Draç* e ndonjë tjetër. Ky raport bëhet dhe më i rrokshëm, kur të kihet parasysh reflektimi i emrave antikë të vendeve e të lumejve në Rumani dhe ndërmjetësia sllave që vërehet në ato emra.<sup>56</sup>

Çështja nëse përveç analizës fonetike dhe etimologjike, edhe analiza morfologjike e emrave topike mund të shtjerë dritë mbi problemin e përcaktimit hapësinor të trevës gjuhësore të kryehershme të shqipes, për mendimin tim do pohuar. Ka gjasë për mua që nyja e mbrapme e cila shërben si eksponent i shquarjes në gjuhën shqipe dhe vërtetohet se është aty me moshë paraantike, prehistorike, me trajtën dyfishe të saj në, mashk. -i, fem. -a, shfaqet në emra të lashta si *Scupi, Scampis, Mathis* më njerën, *Scodra, Butua, Doclea* më tjetrën anë. Ndonëse, si u tha dhe më sipër, nuk shifet përherë qartë në mënyrën si jepen emrat vetiakë të huajt te grekët e te romakët, megjithatë mund të mendohet që romakët, kur ndeshën në këta emra tipin *Scupi* në sistemin e tyre gjuhësor e përfshinë në kategorinë e toponimeve në shumës të tipit *Falerii, Veli* (kështu respektivisht dhe grekët *Skoupoi -n* e tyre) dhe trajtat vëndëse të tipit të *Skampi e Mati* (sot *Mati* në shqipen emër mashkullor lumi) i renditën, si *Scampis e Mathis*, në skemën e lakimit të tretë (*finis, auris*)., ashtu si më vonë bizantinët anasjelltas trajtën e tyre *he Mate (i Mati)* e renditën në skemin e femëro-

<sup>55</sup> Toponimi *Kumul* nuk është lat. *cumulus* (F. Нopoulos), po shq. *kumbull*. — Emrat *Vinjall e Fuiqët*, në Mat nuk flasin në të mir të mendimjt të Städtmüllerit (f. 96) që në Mat nuk ka emra visesh latine.

<sup>56</sup> Z. f. slav. Phil. XXVI 301 vv., Geschichte der Serbokroatischen Sprache (1960) 79 v.

reve të tyre. Edhe më i lehtë ishte grupimi i emrave të tipit *Skodra* në klasën e temave nominale me *-a* të greqishtes e të latinishtes.

Që të përmbillet diqysh pamja e emrave topikë që u shqyrtuan më sipër, duan venduar ata edhe në suazën e hapësirës dhe të kohës. Objekcionit eventual, që ligjet fonetike ushtrojnë ndikimin e tyre edhe mbi emra topikë që gjenden fort larg, duhet përgjegjur se, sikundër na mëson përvoja, vetëm toponimet e rrethit territorial më të afër integrohen zakonisht në strukturën fonetike të një gjuhe, sidomos aty ku, si në rasën tonë, kemi të bëjmë me një sistem të tërë toponimesh të tilla. Sa për objekcionin e mundshëm kronologjik, që bartësit e një gjuhe edhe emra topikë të huaj që u dalin përpara më vonë, dinë t'ia përshtatin sistemit fonetik të vet, sikurse ndodh p.sh. me toponimet sllovene në ligjërimet gjermane e me gjermanet në ligjërimet sllovene, aty duhet sjellë ndër mend se të ndryshimet që kanë pësuar në trajtë emrat e vendeve që u dhanë më lart, kemi të bëjmë fund e majë me ndërrime fonetike të moçme, të cilat shfaqen dhe në trajtimin e elementeve të leksikut të trashëguar të shqipes, ose të huazimeve greke të vjetra e latine. Do t'ishte e tepërt të përmendeshin këto ndërrime fonetike në hollësitë e tyre.

Shqyrtimi i emrave personalë mbetet jashtë këtu, meqë në lidhje me çështjen tonë asgjë nuk do të dilte përtej atyre që ka diktuar dija e gjertanishme.

Për nomenklaturën popullore të detarisë dua të shprehem shkurt.<sup>57</sup> Mendimi i Weigandit, që terminologjia e lundrimit dhe e peshkatarisë është e burimit të huaj në shqipen dhe se mbarë shprehjet e lundrimit janë të huaja e përgjithësisht krejt të reja, në këtë formë është i tepëruar dhe i tillë nuk mund të pranohet plotësisht. Duke e zhvilluar edhe këtë çështje në mënyrë metodikisht të drejtë në tërësinë e saj, dhe me pasje parasysh edhe të shtimit të materialit përkatës që ka dalë në dritë këtë ndërkohë, gjendja paraqitet si vijon: kjo fushë e leksikut të shqipes në shumicën më të madhe është në fakt e burimit të huaj, porse kryesisht në pjesën teknike të saj, në më të shumtat terme të mjeteve të lundrimit e të pjesëve përbërëse të tyre, në emrat e llojeve të peshqve dhe të veglave të peshkimit. Jo shumë ndryshe paraqitet gjendja në të tjerat gjuhë ballkanike të viseve bregdetare ndër to edhe në historinë e re të greqishtes, gjuhë që dihet mirëfilli se nuk ka ndryshuar territorin e saj.<sup>58</sup> Në gjuhën shqipe ndërkaq, krahas me këto, ka edhe një element popullor me termë vendëse si përta i përket detit në përgjithësi, si përta i takon anijes dhe pajisjes së saj, peshkut dhe pjesëve të trupit të tij si edhe në lidhje me veglat e peshkimit. Hynë aty ndër të tjera *det* (në thelb „thellësi”), *vā, gji (deti), grykë (deti), mat, valë suvalë, shkulum*; pastaj *anije*, që shkon me *an, anë*, shumë *enë, me enët e mëdhaja, enët e vogla* anijet e mëdha, a të vogla”, *ena ujtis* „lëshon lagësi, lagëson”, *ballë* (i anijes), *shul, pëlhurë, lugatë* „lopatë barkë”, dhe me një mori emrash popullore të peshqve, me *krehër* „skelet e peshkut”, *halë, verzë, gjuet „gjuaj”* e „peshkoj”, ndër lloje rrjetash *rrahçë, ujicë*, si edhe *palcuer* „purtekë e gjatë-e rrjetës”. E pasur paraqitet dhe terminologjia popullore e faunës e e florës detare, me *breshkujcë, iriq deti, leshterik* „algë” (*lesh*), *likurishtë* „polip”

<sup>57</sup> Khs. për këtë E. Petrovici, *Dacoromania X* 266, *Revue roumaine d'histoire IV* (1965) 6 vv., I. I. Russu *po aty* f. 839.

<sup>58</sup> Khs. sidomos VII *Congresso Internaz. di Scienze Onomastiche* 247 vv., *Revue roumaine de linguistique X* 104, *Studia albanica VII* 1 164 v.

(lëkurë), *yll deti* etj. E shikuar në tërësinë e saj, kjo fushë leksikore, në lidhje me raportin e elementit të trashëguar ndaj të huazuarit, paraqet një pamje, e cila nuk ndryshon qenësisht nga ajo e pasurisë leksikore të së tjerave sfera të jetës, siç janë veshmbathja, bujqësia, ose tregëtia me zejtarinë, dhe hyn në kuadrin e përgjithshëm të visarit leksikor të shqipes, ku dihet se elementi i huazimit mbizotëron mbi atë të trashëgimit. Edhe në këtë njohja e pamjaftë e leksikut të shqipes e ka çuar dijen shpeshherë në përmbyllje të padrejtë. Fakti se këto terme për një pjesë janë të një përdorimi dialektor të kufizuar, nuk do të thotë se ato duhet të jenë të gjitha të reja. E nëse ato pjesërisht — ashtu si ndodh dhe në gjuhë të tjera — janë përftuar me rrugë metafonike, me zhbartje të kuptimit (*ballë, enë, grykë, gji, krehër, pëllhurë, shul* etj.) dhe nëse përdoren edhe për ujërat kontinentale, këndej logjikisht nuk mund të nxirret se nuk kanë ekzistuar lashtërisht edhe si shprehje popullore të detarisë.

Në çështjen e vendit të formimit të shqipes duan pasur parasysh më në fund edhe marrëdhënjet e huazimit të kësaj gjuhe me idiomat fqinjë, dhe aty si huazimet që shqipja ka marrë prej sosh, si edhe elementet e shqipes në ato gjuhë. Të parat dihet se janë studjuar në një masë të gjerë, këto të tjerat në mënyrë të pamjaftë. Të dyja kategoritë e huazimeve meritojnë vëmendje të veçantë, me sa janë në gjendje të kontribuojnë në sqarimin e fazave më të mocme të gjuhëvet përkatëse, duke përfshirë aty edhe shqipen.<sup>59</sup> Përsa i përket ndërkaq problemit që është shtruar këtu, gjurmimi i marrëdhënjeve të shqipes me gjuhët e gjalla të Ballkanit, me sllavishten jugore, greqishten (të mesmen edhe të renë) e rumanishten, tregon se këto marrëdhënje për problemin në fjalë nuk japin gjë pozitive as në pikëpamje të gjeografisë gjuhësore, as në atë të historisë gjuhësore. Në këtë gjë faktet e gjuhës pajtojnë me ato të historisë, duke rrjedhur marrëdhënjet e shqipes me gjuhët e përmendura, kryesisht prej një kohe pasantike, mesjetare — edhe kjo përsëri një provë që çështja e atdheut të kryehershëm të shqipes ka lidhje me rrethanat e kohës antike.

Përsa i takon veçanërisht rumanishtes, Weigandi tezat e tij, „marrëdhënjet rumune — shqiptare të burimit jolatin dëshmojnë për një bashkëjetesë dikur të shqiptarëve e të rumunëve”, „në gjuhën rumune ka elemente latine, trajta e të cilave vetëm kështu mund të shpjegohet, që ato kanë hyrë aty me ndërmjetësi të shqipes”, elementet latine të shqipës dhe të rumanishtes përkojnë aq dukshëm, sa duhet të jenë përftuar në kushte kulturalë, vendore e gjuhësore të barabarta,, i ka përmbledhur në këtë përfundim, që shqipja dhe rumanishtja u formuan në trekëndshin ballkanik qendror që u përmend më lart ku rumanishtja e lashtë e përbashkët, sipas tij mundi e mori veçoritë e shumta joromane, po thjesht shqiptare-trake në shek. e 7 e të 8. Nuk është vendi këtu të hyhet në çështjet që kanë lidhje me këto teza, aq më shumë kur disa sosh me ato që u shtjelluan më lart besoj se kanë marrë një përgjegje; veçse do të them se argumentimin e këtyre tezave e gjej krejt të pamjaftë. Edhe teoria e ditur e substratit, e themeluar prej Miklosichit, teori aq e diskutuar dhe aq e diskutueshme, e përfaqësuar me forma të larmishme, sipas së cilës elementet e përbashkëta të këtyre dy gjuhëve rrjedhin prej një burimi të tretë, këtu mund të preket shkurt vetëm në lidhje me problemin që shrohet. Edhe për

<sup>59</sup> Për shprehjet detare me burim roman në greqishten e mesme Khs. M. Triandap-hyllidis, *Die Lehnwörter der mittelgriechischen Vulgärliteratur* (1909) 131, 139, 143.

arsye të gjeografisë gjuhësore është e mundur në parim që njëra ose tjetra fjalë e përbashkët e këtyre gjuhëve të burojë prej një gjuhe të lashtë jogreke të Ballkanit. Po, duke e lënë këtë pikë mënjanë, kjo teori ndesh në disa objeksione të rënda. Pikësëpari koncepti i substratit ka lidhje me një ndërrim gjuhe; një ndërrim i tillë ka ndodhur në truall të rumanishtes, po jo në të shqipes, ku është me vend më fort koncepti i birërisë, i filiacionit. Përveç kësaj, shumë çifte fjalësh shqiptare-rumune rezultojnë se janë formime të brendshme, dhe relativisht të reja të shqipes. Po të kemi parasysh që nuk mungojnë në anën tjetër dhe elemente rumune në shqipen, atëherë marrëdhënjet e shoqishojme të së dy gjuhëve për pjesë më të madhe me njaft gjasë mund t'i rrjedhojmë nga ndikimet e adstratit, në mënyrë që degët më lindore të shqipes dhe degët më perëndimore të rumanishtes, në kohën pasantike, kanë pasur të dhënë e të marrë fqinjësi. Në këto rrethana konkordancat shqiptare-rumune nuk më duket të sjellin një argument me peshë për një vend lindor të formimit të shqipes.

Po t'u sillemi marrëdhënjeve të huazimit të shqipes të periodes antike, aty elementet greke të vjetra dhe latine të kësaj gjuhe na tregojnë që historia e vjetër e saj është zhdrivilluar në sferën e pandërmjeme të rrethit kulturor greko-romak e të ndikimit gjuhësor të tij. Të njëjtin send dëshmojnë ato të paka elemente parashqiptare, pak a shumë të sigurta, në dy gjuhët klasike, të cilat do të kalohen këtu pa u përmendur.

Që të shprehem edhe këtu sa më shkurt që të jetë e mundur po përmend pikësëpari që huazimet e sigurta prej greqishtes së vjetër jo vetëm, sikurse dihet që prej A. Thumbit e këtej, nuk mungojnë, porse janë më të shumta nga ç'mendohet rëndom, duke përfshirë nja tridhjetë fjalë, përveç disa elementeve më pak të sigurta, sidomos atyre që duket të kenë hyrë me anë të latinishtes. Është gjë e shënueshme që ndër huazimet prej greqishtes së vjetër disa janë të tipit dorik-grek veriperëndimor, si *brukë* „Tamarix gallica nga *myrike*, *drapën drapër* nga *drapanon* për *drépanon* (khs. *drapane* sot në Kefaloni, në Kretë e në cakonishten, ku G. Hatzidakis për mendimin tim me të drejtë gjen një mbeturinë të dorishtes,<sup>60</sup> *pastaj* dhe *trapana* në Itali jugore,<sup>61</sup> *kumbull* nga *kokkymalon* fonetikiisht *kokkumalon*, *merimagë* nga *myrmaks myrmakos* te Teokriti, *mokën mokër* nga *mākhanā*, mollë nga *mālon*, *qull* nga *khýlos khylos* fonetikiisht *klūlos*, *klulos*, *shkop* nga *skāpos* „degë”, *trumzë* „Thymus” nga *thymbra thrymbë* fonetikiisht *thumbra thrymbë* khs. sot *thrumba* në Kefaloni e në Rodos, *trumba tromba* në greçitetin e Italisë jugore.<sup>62</sup> Dhe të tjera elemente greke të vjetra mundet që rrjedhin prej dorishtes, veçse nga forma e tyre nuk mund të shihet me siguri një përkatësi të ky dialekt. Këto dorizma janë me rëndësi në lidhje me problemin tonë, nga që në këtë mes del pyetja se nga i mori shqipja dhe ku i mori. Me pranimin e një vatre ballkanike qendrore ose edhe më lindore të kësaj gjuhe, rruga e përvetësimit të këtyre huazimeve do të mbetej e pashpjeguar. Mendimi që këto të jenë sjellë në viset e brendshme me anë të tregëtisë së kolonistëve doras,<sup>63</sup> ndesh në faktin që mokra dhe bimët e

<sup>60</sup> Khs, autorin, „Disa faza të moçme të shqipes në dritën e gjuhëve fqinjë” Revistë shkencore e Institutit pedagog dyvjeçar Shkodër 1 (1964) 5 vv., Z. f. Balkanologie II (1964) 6 vv.

<sup>61</sup> Einleitung in die Geschichte der neugriechischen Sprache 104.

<sup>62</sup> G. Rohlf's, *Etymol. Wörterbuch der unterit. Graziat*, 571, *Lexicon graecanicum Italiae inferioris* 131.

<sup>63</sup> Rohlf's, *Etymol. Wörterb.*, 796, *Lex. graec.* 181.

kuzinës zakonisht nuk janë mall tregëtie. Aty do të mbetet pa përgjegje edhe pyetja pse këto lloj fjalësh i mungojnë rumanishtes, çështja e elementeve greke të vjetra të së cilës paraqitet përgjithësisht e vështirë. Po t'i sillemi në këtë mes historisë, shohim në kohë të vjetër bregdetin shqiptar në krye të herës të qarthuruar me ngulime dorike si Lissos, Epidamnos, Apollonia, pas së cilave më në jug vinin Aulon me Orikon, dhe në hinterland ndër të tjera Amantia, Byllis, e Buthroton, të cilat më të shumtat ishin themeluar në truall të ngulimeve vendëse. Fare në jug fiset epirote puqeshin me dialektet greke veriperëndimore-dorike të Epirit, Akarnanisë e Etolisë. Më afër mendsh nga të gjitha është që huazimet dorike të dialekteve të këtyre kolonive dhe të dialekteve greke veriperëndimore depërtuan te të parët e shqiptarëve të sotëm me rrugën bregdetare dhe kontinentale. Kjo do të thotë që kolonistët doras i gjetën këta në vend, ose që vonë-vonë (jo më vonë se në kohën kur në qytetet bregdetare në fjalë flitej ende dorisht) banorët e tyre kishin marrëdhënie fqinjësie me një popullësi parashqiptare. Ky përfundim në thelb nuk pëson asnjë ndryshim, po të supozojmë që fjalët e përmendura më sipër, ato që përmbajnë një *-u-*, rrjedhin prej një kohe më të vjetër të huazimit, kur në greqishte përdorej ende një shqiptim me *-u-*, i cili në ballë ka qenë i përgjithshëm dhe në kohë historike ishte ende i gjallë në shumë dialekte.<sup>64</sup>

Elementi latin i shqipes, si për vëllim si format e tij, është i caktuar të kontribuojë në mënyrë qenësore në sqarimin e çështjes së vendit të formimit të shqipes. Lidhur me vëllimin, edhe nga një tjetër anë është theksuar, që në këtë çështje nuk duhet lënë pas dore fakti që kjo gjuhë ka pësuar një ndikim romak shumë të fortë.<sup>65</sup> Në lidhje me format ka qenë vënë re prej kohësh (B. Kopitar, 1829) që shqipja me shqiptimin e *k* -së si okluzivi palatal para *e* -së dhe *i* -së (*ke, ki*), ka ruajtur një gjendje më të vjetër, duke u larguar kështu prej rumanishtes. Me këtë dhe me trajtimin e *ki* -së elementi latin i shqipes sipas fjalëve të Meyer-Lübkes paraqet një stad gjuhësor më të mocëm se çdonjëra nga gjuhët romane.<sup>66</sup> Kësaj vjen e i shtohet dhe kjo, që shqipja edhe në reflektimin e *tj* -së latine largohet nga rumanishtja. Ndërsa ky reflektim në rumanishten sipas S. Puscariut hyn në karakterin e mbarë gjuhëve romane, i përket pra në çdo rasë shekullit të 3, të erës sonë,<sup>67</sup> mënyra e trajtimit që ka shqipja, sikundër vëren N. Jokli,<sup>68</sup> na çon në një kohë më të lashtë, dukuri kjo sigurisht me rëndësi për historinë e gjuhës. Po të kemi parasysh dhe elementet leksikale, qëndrimin ndërmyjetës të shqipes në lidhje me to, për të cilin u fol edhe më lart, pra më një anë afrimet me rumanishten, më një tjetër me dalmatishten dhe në një masë të konsiderueshme edhe me gjuhët romane perëndimore, është e pamundur të mos shihet se në këtë qëndrim, përveç faktorëve të kohës, kanë pasur pjesë dhe faktorë të hapësirës: Ndërsa ky karakter arkaik i elementit latin të shqipes shpie në një periudë, e që është përpara romanizimit të Dakisë, këto dukuri, së bashku me lëndën toponomastike, tregojnë në mënyrë të prerë

<sup>64</sup> Cf. Haebler, *Sudost-Forschungen* XXIII (1964) 426. Po khs. ndërkaq Stadtmüllerin f. 81 shën. 24.

<sup>65</sup> Për këtë shqiptim E. Schwyzer, *Griechische Grammatik I* (1939) 181.

<sup>66</sup> H. Pedersen, *The Discovery of Language*. Linguistic Science in the 19 Century (1967) 68.

<sup>67</sup> *Mitteilungen des Instituts für rum. Sprache Wien I* (1914) 32.

<sup>68</sup> *Locul limbii române între limbile romanice* (1920) 27.

që rumanishtja dhe shqipja janë formuar në treva të ndryshme të Gadishullit Ballkanik.

Kjo do të ishte një përpjekje për të shtruar problemin e vendit të formimit të gjuhës shqipe në vijat kryesore dhe për të kontribuar në zgjidhjen e tij. Shumë çështje që lidhen me të, mbeten si të tilla dhe duhet t'u lihen kërkimeve të veçanta në të ardhmen.

Rezultati i kërkimit tonë është ky, që shqipja është formuar në përgjithësi në trevën e sotme gjuhësore me përfshirje edhe të bregdetit, që kjo trevë nuk ka pësuar ndonjë ndryshim qenësor gjatë kohëve.<sup>69</sup> Dardania dhe Shqipëria veriore bashkë me krahinën e Matit duhet të shikohen si pjesë të trevës gjuhësore të kryehershme, jo si kjo vetë, mendimi i përkundërt është i shikuar tepër ngushtë.<sup>70</sup> Përmbyllja që del nga teoria e Matit që area gjuhësore e sotmja është një trevë ekspansioni, është për të rishikuar, edhe nëpërmjet të së dhënave historike. Do menduar edhe mos paraqet area e sotme më fort një trevë restriktioni; ose mbase mos janë të drejta të dyja koncepcionet, duke pasur vlerë për epoka historike të ndryshme, e para për një periudë më të re, për mesjetën e plotë dhe të vonën, e dyta për një periudë më të vjetër të gjuhës.

*Prof. Eqrem Çabej*

#### LE PROBLEME DU TERRITOIRE DE LA FORMATION DE LA LANGUE ALBANAISE

##### R é s u m é

Un des principaux problèmes de la paléontologie de la Péninsule balkanique et de l'histoire antique de ses langues est, comme on le sait, la question de la source de l'albanais, donc la question du lien de parenté avec les langues non grecques de l'antiquité et celle du territoire où cette langue a été formée comme grandeur donnée et indépendante.

Pour une région comme la péninsule balkanique, où il n'y a pas de renseignements ni de données effectives sur le passage de l'ancienne situation ethnique à la situation actuelle, où les mouvements des peuples et des tribus ont été si fréquents, le problème de la source ethnique des unités contemporaines nationales ne devient que plus difficile.

Dans la situation particulière où la tradition de l'écriture de l'albanais, dans l'état actuel de nos connaissances, commence uniquement au XV e siècle, et la question des origines et du territoire de sa formation remontent, au contraire, à une période de beaucoup antérieure à ses porteurs, il ne reste à cette méthode que de s'appuyer essentiellement sur la reconstruction et la comparaison. C'est par là qu'on doit chercher les fils qui relient le passé au présent, et en partant de l'état actuel des choses, remonter par degré les âges.

Si l'on regarde dans son ensemble la situation préhistorique à laquelle ne s'opposent point d'autres traits de la langue, on doit reconnaître à l'albanais, tant au point de vue de la langue que de la géographie, une certaine position centrale, intermédiaire entre l'Occident et l'Orient. Si l'on prend en considération les emprunts anciens de l'iranien, les rencontres avec quelques langues finno-ougriennes, et surtout le fait que les noms de deux massifs, les Carpathes et les Beskides trouvent leur explication à travers l'albanais, et seulement à travers cette langue, dans karpë „roche à pointe, roche escarpée” et bjeshkë „haute montagne, alpe”, alors on ne se hasarderait pas trop à affirmer que le berceau de l'albanais à son stade prébalkanique dans la période européenne des langues indo-européennes a été une zone située quelque part au N. de la Péninsule balkanique.

<sup>69</sup> Arhiv za arb. starinu I 43.

<sup>70</sup> Khs. edhe SUFFLAY, *Un. Ungarische... Rundschau* V (1916) 11.

<sup>71</sup> Abanologji (1947) 46.

Passant à la période balkanique, on doit noter que la question de la formation n'étant pas seulement une question de géographie, mais aussi une question concernant l'histoire de la langue, on s'arrêtera plutôt à son examen purement linguistique. Une question, souligne Çabej, est de toute évidence en cela: le chemin de la formation de cette langue n'a pas été rectiligne. Déplacements et mélanges ethniques, migrations intérieures et convergences, l'évolution de la diversité à l'unité à côté du démembrement des unités d'antan, ce sont là autant d'éléments constitutifs de son apparition.

On sait que sur la question ici traitée il existe deux directions de recherches. Suivant l'une, l'albanais est domicilié ici depuis l'antiquité. Selon l'autre, ses porteurs ont migré, à cette époque ou plus tard, pour s'installer dans l'habitat actuel, venant d'une région plus à l'Est, respectivement plus au Nord.

D'un examen d'ensemble de ces opinions, Çabej remarque une certaine opposition entre les historiens et les linguistes. Les historiens, à très peu d'exception près, vraisemblablement à cause de l'absence de sources anciennes, ont laissé cette question entre les mains des linguistes. Ces derniers ont laissé souvent échapper les données géographico-historiques et ils se sont ainsi écartés parfois du terrain de la réalité.

Tout d'abord, l'opinion assez répandue, selon laquelle la région linguistique de l'albanais se serait déplacée, dans la période historique, d'un territoire situé plus à l'Est ou plus au Nord, à son territoire actuel, est dénuée de base historique. Ce serait un phénomène d'exclusion, que l'émigration et l'établissement de toute une population, effectués à l'intérieur de la sphère du monde romain et grec et à la lumière complète de l'histoire, se soient produites sans être aperçues par l'histoire. La langue vernaculaire fournit de tels témoignages sur l'histoire du peuple, qu'on constate qu'à des éléments qui vivaient en transhumance, on a l'élément sédentaire, à côté du guerrier, l'artisan pacifique. Il suffit de remarquer, à cela, que le témoignage de la langue relève un caractère plutôt urbain que rural, contrairement à la Roumanie. Cette opposition avec la Roumanie on l'a aussi dans la langue ecclésiastique: l'élément latino-romain et en partie aussi l'élément gréco-byzantin prédominant en albanais, et l'élément slave étant complètement et manifestement absent, voilà ce qui atteste d'une vie urbaine à organisation ecclésiastique formée déjà avant l'arrivée des Slaves dans ces régions.

Le problème de cette formation de la langue se ramène en dernière analyse, du point de vue linguistique, à la question s'il y a, ou non, d'anciennes traces de l'albanais dans la péninsule des Balkans, dans l'affirmative, où se trouvent-elles? On constate que ni en Pannonie, ni en Dalmatie ou en Bosnie, ni en Transylvanie ne se retrouvent nulle part d'anciennes traces de l'albanais, et on doit ajouter à ceux-ci, naturellement, au sud, les régions grecques.

En appliquant ce procédé d'exclusion et le combinant avec celui de la restriction, en écartant une à une les régions qui ne sont pas à considérer et en resserrant de plus en plus le territoire qui peut être considéré positivement sous cet aspect, on aboutit à une région géographiquement assez étendue à l'ouest des Balkans. A l'intérieur de cette région, Naissus-Nish, Scupi—Shkup et Astibos—Shtip, témoignent, entre autres, que la Dardanie avec les régions de la Macédoine et de la Paionie qui la bordent font partie du territoire de la formation de l'albanais. Si l'on se tourne vers la région qui s'étend entre les frontières de l'Etat actuel albanais, on observe que pour cette période linguistique, l'équation Scodra—Shkodër concorde parfaitement avec les règles phonétiques de l'albanais.

En partant des toponymes de source non latine, et en descendant du Nord au Sud, en rapport avec les réflexes de Naissus, Scupi et Scodra, qu'on vient de mentionner plus haut, au Nord d'Oulkinion: Ulqi Ulqin et de la région de la langue albanaise, se trouve le nom de Raguse, Ragusium, dont l'ancienne dénomination albanaise Rush atteste le rôle intermédiaire de la langue albanaise. Plus au sud, le nom de la ville qu'on reproduit en grec comme Lissos, et en latin comme Lissus, et qui en albanais est Lesh, se présente comme une forme qui correspond surtout à shpesh du lat. *spissus* „épais, touffu”. Qafa e Prushit, qui se trouve plus au N., peut être la continuation du nom des Pirustes (Pirustae, Perustae d'après l'opinion d'A. Saraçi). Dans ce groupe rentre aussi Candavia: l'évêché Chunavia. à mutation de nd: n. régulière en albanais. Plus à l'Est Skárdos Skárdus mons s'est développé d'après les lois phonétiques de l'albanais dans l'actuel Shar. Les noms des fleuves Drinus: Dri Drini et Mathis: Mat sont aussi des évolutions de l'albanais. Un ancien élargissement de l'albanais à l'aide du suffixe -n, Skampin-, attesté en latin comme Scampinus dérivé de Scampus (l'Elbasan actuel), a donné régulièrement dans la bouche des Albanais Shkumbi Shkumbini

avec l'estompement de l'e prétonique en u dans le dialecte respectif de l'Albanie centrale et par l'assimilation du groupe mb en m dans le dialecte guègue. Plus au sud, Aulon a donné Vlonë Vlorë, conformément aux lois phonétiques de l'albanais. A l'extrême sud, la forme Çam — de la Çamëri nous donne l'exemple de la dénomination d'une région d'après le nom du fleuve qui la parcourt, le Thyamis de l'antiquité.

Passant aux noms trisyllabiques de lieu, on a, entre autres, Dýrrachion Dýrrachium alb. Dýrrës, Isamnus: Ishëm Ishm, Drivastum: Drisht, Pólatum: Pulët Pult, qui témoignent tous d'une évolution ininterrompue des noms antiques ou hauts-médiévaux.

C'est dans ce groupe de toponymes trisyllabiques que rentre, au point de vue territorial et même que de celui typologique, le nom ancien des Albanais: Arbën Arbër, en rapport avec l'Albanoi connu de la carte du monde de Ptolémée. C'est un nom qui, en concordance avec la situation exposée tout à l'heure, doit avoir été prononcé dans le pays 'Albanoi, à accent initial, comme Dýrrachium, Isamnus, etc. Contre H. Hirt, H. Pedersen a remarqué que ce nom, en raison du b (non pas v), ne peut pas avoir été emprunté au grec à une époque tardive, mais qu'il doit être sans conteste aussi ancien que les Albanais. Mais le nom, en raison d'arb — (non pas rab—), pas même de source slave. Çabej constate qu'il tire son origine du nom de lieu de l'antiquité, qui appartient à la même étendue géographique, dont font partie aussi Drivastum, Dýrrachium, etc.

En passant à la question des noms latins et romains de lieu, Çabej s'oppose à l'opinion de Weigand qui soutient qu'ils ne se présentent pas sous la forme phonétique albanaise, mais latino-dalmate ancienne. Cette influence est à exclure, du fait que dans cette langue, l'o bref en position libre, a donné, u, en position couverte ua, et l'o long en position libre au, en position couverte a. En fait, des noms invoqués par Weigand à confirmation de son hypothèse, précisément Valbona et Domni, d'une part, et Petrosa avec Patosa, de l'autre, auraient donné une forme phonétique tout à fait différente de celle qu'ils ont effectivement. Tout de même, la question de l'existence continue d'un élément ethnique et linguistique d'origine provinciale romaine et proche à celui de la Dalmatie, existence admise par plusieurs auteurs même pour une période s'étendant jusqu'au bas moyen âge, constitue un problème scientifique qui mérite d'être suivi plus loin.

Sur la question des emprunts slaves, qui l'oppose à I. Popović, Çabej observe que, dans le domaine onomastique, ces noms de régions sont limités, du côté slave, et qu'au contraire, du côté albanais ils présentent souvent des rapports sémantiques avec la matière non onomastique, avec le lexique appellatif. Lim, Buenë Bunë (Bojana), Dango: Dejë s'expliquent par les moyens de l'albanais et de même Mati.

L'examen des noms de personne reste ici exclu, du fait qu'il en résulterait, en rapport avec la question examinée, rien de plus que ce que la science a établi jusqu'à présent. Sur la nomenclature populaire maritime, Çabej fait noter qu'en traitant cette question d'une manière méthodiquement judicieuse dans sa totalité et en tenant compte aussi de l'augmentation des matériaux afférents, rassemblés depuis Weigand, la situation est la suivante: ce domaine du lexique de l'albanais est, dans sa grande majorité, de source étrangère, mais surtout pour sa partie technique, dans la plupart des termes des moyens de navigation et de leurs parties constitutives, dans les noms des espèces de poissons et des instruments de pêche. La situation dans les autres langues balkaniques des régions côtières n'est pas très différente, même dans l'histoire moderne du grec, langue dont on sait parfaitement qu'elle n'a pas changé son territoire. A côté de ces emprunts, il y a aussi en albanais quelque élément populaire à termes autochtones, tant pour ce qui concerne la mer en général, que pour ce qui est des vaisseaux et de leur armement, des poissons et des diverses parties de leur corps, ainsi que des instruments de pêche. Et Çabej donne plusieurs exemples à le prouver.

Dans la question du territoire de la formation de l'albanais, on doit enfin avoir en vue aussi les rapports d'emprunt de cette langue avec les idiomes voisins, tant les emprunts que l'albanais leur a faits, que les éléments de l'albanais qui se retrouvent dans ces langues. Pour ce qui concerne le problème posé ici, la recherche des rapports de l'albanais avec les langues vivantes des Balkans, avec le slave du Sud, le grec (Moyen et moderne) et le roumain, atteste que ces rapports ne fournissent rien de positif sur le problème en question, ni du point de vue de la géographie linguistique, ni de celui de l'histoire linguistique. Dans ce domaine, les faits de la langue concordent avec ceux de l'histoire, étant donné que les rapports de l'albanais avec ces langues remontent principalement à l'époque immédiatement postérieure à l'antiquité, au moyen âge — ce qui constitue une nouvelle preuve du fait que la question du tout premier territoire de l'albanais se rattache aux circonstances de l'antiquité.

Si l'on s'arrête aux rapports d'emprunt de l'albanais de la période antique, alors là les éléments grecs anciens et latins de cette langue nous montrent que son histoire ancienne s'est déroulée dans la sphère immédiate du milieu culturel gréco-romain et de son influence linguistique. C'est également ce dont témoignent le peu d'éléments pré-albanais, plus ou moins sûrs, dans les deux langues classiques. Et Çabej rappelle plusieurs de ces éléments.

L'élément latin dans l'albanais, tant par sa quantité que par ses formes, est destiné à contribuer de manière essentielle à élucider la question du territoire de formation de l'albanais. En ce qui concerne le volume, il a été déjà souligné sous un autre aspect également, qu'en cette question on ne doit pas oublier le fait que cette langue a subi une très forte influence romaine. Quand aux formes, il a, depuis longtemps déjà, été observé (B. Kopitar, 1829) que l'albanais, avec sa prononciation du k comme une occlusive palatale devant l'e et l'i (ke, ki), a conservé un état plus ancien, s'écartant ainsi du roumain. Par ce phénomène et par le traitement de kj, l'élément latin de l'albanais, selon les dires de Meyer-Lübke, représenterait un stade linguistique plus ancien qu'aucune autre langue romane. A cela vient s'ajouter le fait que l'albanais dans le reflet du tj s'écarte du roumain. Alors que ce reflet en roumain, d'après S. Puscariu, participe de l'ensemble des langues romanes, qu'il appartient donc en tout cas au III e siècle de notre ère, la manière dont l'albanais traite ce groupe de, consonnes, comme le remarque N. Jokl, nous conduit à une époque plus ancienne, ce qui assurément, constitue un phénomène important pour l'histoire de la langue. Si l'on tient compte aussi des éléments lexicaux, l'attitude intermédiaire de l'albanais en ce qui concerne ces derniers, attitude déjà évoquée, et, par suite, similitudes avec le roumain, d'une part, et, celles avec le dalmate et dans une mesure notable avec les langues romanes occidentales, d'autre part, il est impossible de ne pas constater que dans cette attitude sont intervenus non seulement des facteurs temporels mais aussi des facteurs spatiaux. Alors que ce caractère archaïque de l'élément latin dans l'albanais conduit à une période qui précède la romanisation de la Dacie, ces phénomènes, en même temps que les matériaux toponomastiques, montrent nettement que le roumain et l'albanais se sont formés dans des régions différentes de la péninsule des Balkans.

Le résultat de cette étude se ramène à l'affirmation que l'albanais s'est formé dans l'ensemble sur son territoire linguistique actuel, y compris le littoral, et que ce territoire n'a subi aucun changement essentiel au cours des temps. La Dardanie et l'Albanie septentrionale en même temps que la région de Mati doivent être considérées comme une partie du premier territoire linguistique, et non pas comme ce territoire même, ce qui représenterait une vue trop étroite de la question.

La conclusion qui se dégage de la théorie qui fait de Mati le berceau de la langue et du peuple albanais, et selon laquelle le territoire linguistique actuel de l'albanais serait une zone d'expansion, est à revoir à la lumière des données historiques également. Il est même à considérer si l'aire actuelle ne constituerait pas plutôt une zone de restriction. Peut-être encore ces deux conceptions sont-elles également justes, étant toutes deux valables pour des périodes historiques différentes, la première pour une période plus récente, pour le cœur du moyen âge et le bas moyen âge, la seconde pour une période plus ancienne de la langue.